# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7890 E mërkurë 22 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)



PR PRESTIGE Resort

BEER KORÇA ... edhe sot më e mira


Opinioni i Ditës

Nga HALIL MATOSHI

## Për poetët, librat dhe fashizmin



Kur gjatë majit '99 u intensifikue fushata ajrore e NATO-s, pas ofensivës së forcave serbe në Gallap, e dija me saktësi se librat janë anmiqtë ma t'mdhaj ...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga JORGJI KOTE

## Sekret diplomatik, por edhe informim publik!



Kur kandidatura e Sekretarit Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, u paraqit për miratim prillin e kaluar, disa senatorë e kundërshtuan vetëm pse ai nuk u kishte ....

Vijon në faqen 21




Zbulohet urdhri "sekret" i Hekuran Isait

# Masat pas 'Revoltës së Qafë-Barit': Gaz lotsjellës dhe uniforma të verdha të dënuarve

Sot, 35-vjetori i revoltës së famshme më 1984. Plani i qeverisë: Më shumë ushqim për ushtarët

Nga DASHNOR KALOÇI

Plot 35 vjet më parë në 22 majin e vitit 1984, në kampin-burg të Qafë Barit në rrethin e Pukës ky vuanin dënimet një numër i madh të dënuarish politikë të regjimit komunist të Enver Hoxhës, ndodhi një ngjarje e jashtëzakonshme që ...

Në faqet 18-19

## AGJENCIA E KADASTRES: KUSH PERFITON HIPOTEKEN E TRUALLIT TE NDERTIMIT

# LEGALIZIMET, EMRAT E 2000 PRONAREVE QË MARRIN TAPITE

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, kompensohen pronarët. Agjencia e Kadastrës: Si ndahen 230 milionë lekë për 510 vetë, përfituesit në Tiranë dhe në rrethe



*(Në foto)* Ndertime informale

Në faqet 8-9

AFROHET PROTESTA

## Basha: 30 qershori, tentativë për grusht shteti. Kryemadhi, grave: Dilni në shesh

Në faqen 4

KREU I KADASTRES

## Artan Lame: Si do të zgjidhen mbivendosjet e pronave në Shqipëri

Në faqen 5

LISTA E RE

## Emrat e 1600 infermiereve që do t'i nështrohen provimit të shtetit

Në faqet 11-12

"VIP PAGES"

## Ribashkohet 'Ritfolk', Altin Goci: Surprizat e datës 8 qershor, e kërkonin fansat

Suplement

ANALIZA E RASTEVE



## Studentët e Drejtësisë te "Luarasi", kombinim teori-praktikë

Në faqen 10

Nis operacioni FRONTEX për kontrollin e kufirit me oficerë nga 11 vende

# Deputetët tanë në Holandë, BE: S'ka rikthim vizash

*Taulant Balla: Krimi s'ka atdhe, shqiptarët demonizohen nga media*

Ndërsa në Tiranë Komisioneri, Dimitris Avramopoulos bënte të ditur se në BE nuk kishte mbërritur një kërkesë e Holandës për rikthimin e vizave për Shqipërinë, në Hagë, deputetët holandezë do t'i shprehnin bindjen se rezoluta që miratoi parlamenti para pak



javësh nuk do të zbatohej. Konfirmimi ka ardhur nga deputetët e Komisionit për Çështjet e BE-së në Parlamentin e Holandës gjatë një seance dëgjimore që zhvilluan dje me delegacionin parlamentar që kryesohet nga kryetari i Kuvendit ...

Në faqen 2

RIKTHIMI I VIZAVE

VIZITA

Deputetët holandezë zhvilluan një seancë dëgjimore me homologët e tyre shqiptarë

# Holanda: Rezoluta nuk realizohet, për integrimin presim raportin

## Balla: Shqiptarët po demonizohen padrejtësisht nga media



Pas përfundimit të marrëveshjes për FRONTEX

Ndërsa në Tiranë Komisioneri, Dimitris Avramopoulos bënte të ditur se në BE nuk kishte mbërritur një kërkesë e Holandës për rikthimin e vizave për Shqipërinë, në Hagë, deputetët holandezë do t'i shprehnin bindjen se rezoluta që miratoi parlamenti para pak javësh nuk do të zbatohej. Konfirmimi ka ardhur nga deputetët e Komisionit për Çështjet e BE-së në Parlamentin e Holandës gjatë një seance dëgjimore që zhvilluan dje me delegacionin parlamentar që kryesohet nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Gramoz Ruçi. Sipas njoftimit të shpërndarë nga Kuvendi i Shqipërisë mësohet se "në lidhje me Rezolutën e Parlamentit holandez për rivendosjen e vizave, deputetët e Komisionit pranuan se janë të vetëdijshëm që kjo nuk mund të realizohet, por e interpretuan atë si një veprim sensibilizues për nxitjen e luftës kundër krimit". Ndërkohë që në përgjigje të interesimit të deputetëve holandezë, Kryetari i Kuvendit Ruçi u shpjegoi situatën politike në Shqipëri dhe nënvizoi se opozita ka pasur akses të plotë në administrimin dhe kontrollin e zgjedhjeve të vitit 2017 dhe vetë i ka certifikuar këto zgjedhje; ka gëzuar të gjitha kushtet dhe mundësitë për ushtrimin e kompetencave parlamentare dhe të kontrollit të qeverisë, por nuk i ka shfrytëzuar. Deputetët e Komisionit kërkuan vlerësimin e delegacionit shqiptar nëse është apo jo gati Shqipëria për hapjen e negociatave. "Po, Shqipëria është gati për çeljen e negociatave në qershor, sepse i ka bërë në mënyrë shembullore detyrat e saj të shtëpisë. Me reformën në drejtësi, si kryereforma e integrimit, Shqipëria ka dhënë një shembull jo vetëm për vendet aspirante, por edhe për vendet e BE-së", - mësohet të jetë përgjigjur Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruci. Ndërsa kryetari i Grupit Parlamentar të PS Taulant Balla nënvizoi se politikanët dhe vendimmarrësit duhet të dallojmë perceptimin mediatik nga perceptimi real i njerëzve për kriminalitetin. "Shqiptarët që punojnë e jetojnë në Holandë janë qytetarë normalë e dinjitozë, por demonizohen padrejtësisht nga media. Kriminelët nuk kanë as ngjyrë, as atdhe. Ata duhet t'i luftojmë bashkërisht dhe qeveritë dhe policitë e Shqipërisë dhe Holandës po bëjnë pikërisht këtë", - është shprehur Balla. Deputetet e Komisionit vlerësuan mjaft pozitivisht konstatimin që Shqipëria po i kryen këto reforma, sepse janë të rëndësishme, të dobishme dhe të dëshiruara nga qytetarët e saj, jo thjesht si kërkesa të hapjes së negociatave. Deputetët holandezë vlerësuan gjithashtu bashkëpunimin efikas të qeverisë shqiptare me qeverinë e Holandës për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, i cili ka filluar të japë rezultatet e para, të cilat duhet të thellohen. Gjatë kësaj vizite delegacioni shqiptar u takua edhe me Kryetaren e Parlamentit të Holandës, Khadija Aribi, e cila vlerësoi arritjet e Shqipërisë në fushën e reformave dhe nënvizoi në mënyrë të veçantë arritjet në fushën e sundimit të ligjit. Në lidhje me hapjen e negociatave, Kryetarja Arib vuri në dukje se Parlamenti i Holandës pret publikimin e Raportit të Komisionit Evropian, si edhe të raporterëve të Komisionit Parlamentar për Evropën, që ishin për vizitë në Shqipëri, në fillim të muajit maj. Ndërsa zëvendësministri për Bashkëpunimin Europian në Ministrinë e Jashtme të Holandës, Thijs van der Plas në takimin që pati me parlamentarët shqiptar theksoi se qeveria holandeze është plotësisht e përkushtuar ndaj zgjerimit të BE-së, si një obligim moral, nevojë historike dhe në dobi të interesave të vetë BE-së.


Delegacioni shqiptar gjatë takimit në parlamentin holandez

**KRIMINALITETI**

"Shqiptarët që punojnë e jetojnë në Holandë janë qytetarë normalë e dinjitozë, por demonizohen padrejtësisht nga media. Kriminelët nuk kanë as ngjyrë, as atdhe. Ata duhet t'i luftojmë bashkërisht dhe qeveritë dhe policitë e Shqipërisë dhe Holandës po bëjnë pikërisht këtë", - është shprehur Balla.

## Scheffer: Shqipëria ka rrugë me gropa drejt integrimit në BE



Jaap de Hoop Scheffer, ministër shteti i deleguar nga Mbreti brenda qeverisë së Holandës dhe ish-Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, shprehet optimist për çeljen e negociatave të Bashkimit Europian me Shqipërinë. Ai ka zhvilluar dje një takim me delegacionin shqiptar që po viziton parlamentin holandez, ndërsa theksoi se ekziston një frymë që nuk është pro zgjerimit të BE-së. Për këtë arsye ai theksoi se Shqipëria ka një rrugë të vështirë para në rrugën e saj drejt BE-së. "Më shpjeguan të dyja palët, opozita dhe qeveria, për ambiciet e Shqipërisë për integrimin. Zgjerimi i BE nuk është ndalur. Unë thashë që Shqipëria ka një rrugë me gropa para, jo për shkak të Shqipërisë, por, sepse në BE ka një frymë populiste që nuk është pro zgjerimit të Unionit. Kam inkurajuar miqtë e mi shqiptarë që t'i tregojnë Bashkimit Europian se Shqipëria është serioze me reformat dhe momenti do të vije që Shqipëria të marrë sinjal pozitiv nga Brukseli. Ndaj mendoj se procesi nuk ka ndalur",-tha ai gjatë një deklarate për mediat që shoqëronin delegacionin shqiptar në Hagë.

## SHKURTE

### Kuvendi seancë trajnuese me deputetët e rinj për njohjen e detyrave

Kuvendi i Shqipërisë organizoi dje një takim informues me deputetët e rinj, për prezantimin e shërbimeve të kuvendit, detyrave dhe të drejtave në lidhje me statusin e deputetit. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe dy zëvendëskryetarët e Kuvendit, Vasilika Hysi dhe Myslym Murrizi. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit Genci Gjonçaj ndërsa i uroj suksese deputetëve të cilët kanë bërë betimin së fundmi, siguroi mbështetje të vazhdueshme për nevojat e tyre në punën si ligjvënës. Gjithashtu, ai gjatë fjalës së tij foli për transparencën parlamentare në faqen zyrtare të Kuvendit, mënyrën se si funksionon Kuvendi dhe theksoi se hapja e tij ndaj publikut është një element kyç. Pjesë e takimit ishin shërbimet e Kuvendit dhe staf përfaqësues, të cilët bënë analiza dhe prezantime të ndryshme të punëve të përditshme, sipas departamenteve përkatëse. Kështu, në këtë takim deputetët e rinj u njohën me Shërbimin e Komisioneve Parlamentare, Shërbimin Juridik, Shërbimin e Marrëdhënieve me Jashtë, Shërbimin e Trajtimit të Deputetëve, Shërbimin e Marrëdhënieve me Publikun, Shërbimin e Teknologjisë së Informacionit etj.

### Forcimi i Kodit Penal, "Siguria" kalon në parim 22 ndryshimet

Komisioni për Sigurinë, shqyrtoi dhe miratoi në parim propozimin për disa ndryshime të" Kodit penal te Republikës së Shqipërisë" që vjen si propozim i një grupi deputetësh të mazhorancës . Në fjalën e saj kryetarja e komisionit Ermonela Felaj theksoi se "Janë 22 nene të cilat mendohen t'i shtohen kodit penal duke bërë të mundur kështu reflektimin e disa problemeve të cilat tanimë janë të evidentuara në praktikën gjyqësore, por që ndeshen me vakum ligjor". "Domosdoshmëria për amendimet në Kodin Penal për disa çështje, si prishja e qetësisë dhe rendit, dhuna në shëndetësi, dhuna në aktivitete sportive, dhuna ndaj funksionarëve publikë apo të zgjedhurve, ka lindur referuar ngjarjeve të muajve të fundit ku incidentet e dhunës, kanë qenë të shpeshta. Me qëllim dënimin e çdo veprimi dhune dhe parandalimin e dhunës në shoqëri, propozohet ashpërsimi i dënimeve për veprat e dhunës ndaj policit, mjekut, sportistit, arbitrit dhe trajnerit, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve" - tha deputeti Ulsi Manja në cilësinë e një prej deputetëve propozues. Gjithashtu, projektligji adreson dhe disa ndryshime të rëndësishme që lidhen me sigurinë ushqimore, si një nga çështjet më aktuale.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:**0688087823-*email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**




Nis operacioni i FRONTEX për kontrollin e kufijve për parandalimin e emigracionit

# Rikthimi i Vizave, BE: Nuk kemi marrë asnjë kërkesë nga Holanda

## "Nëse mund të ndodhë, do të bëjmë një analizë të kujdesshme"

Kufijtë mes Shqipërisë dhe Greqisë, krahas policive dhe forcave të sigurisë të të dyja vendeve do të ruhen edhe nga një operacion i shtuar i Bashkimit Europian, që do të veprojë nëpërmjet FRONTEX, Agjencisë Evropiane për Ruajtjen e Kufijve. 50 oficerë nga 11 shtete të ndryshme të Bashkimit Europian mbërritën dje në Tiranë dhe duke nisur që nga dita e sotme do të dislokohen në zonën kufitare tokësore mes Shqipërisë dhe Greqisë për ndalimin e emigrantëve që synojnë të përdorin Shqipërinë si trampolinë për të kaluar në vendet e BE-së. Shqipëria bëhet kështu i pari vend ku FRONTEX do të operojë jashtë vendeve të Bashkimit Europian. Në ceremoninë e nisjes së punës operacionale të misionit Frontex në Shqipëri kryeministri Edi Rama theksoi se Shqipëria tashmë po jep ndihmën e saj për sigurinë në Bashkimin Europian. "Ne do të jemi në gjendje t'u tregojmë miqve dhe partnerëve në BE edhe më mirë edhe më shumë fakte dhe prova të padiskutueshme për të qenë në këtë copëz të vogël të Europës një partner i besueshëm dhe tërësisht i besueshëm në përballimin e flukseve migratore", - tha Rama. Gjithashtu, ai evidentoi faktin që shqiptarët janë një nga popujt që dëshirojnë më shumë se çdo popull tjetër të jetë anëtarë të BE-së. "Të gjithë atyre që janë këtu sot të ardhur nga jashtë dua t'ju them se kanë ardhur në një vend që, sipas edhe anketës më të fundit të Komisionit Europian, 93% e njerëzve mbështesin integrimin në Bashkimin Europian. Ne nuk jemi naivë në këtë dashuri thuajse të verbër për Bashkimin Europian që sot kërcënohet nga verbëria ndaj historisë së Bashkimit Europian. Ne jemi thjesht dhe vetëm pjesë e një territori, që luftën nuk e ka parë thjesht në TV në arkivat bardhezi, apo përmes filmave të krijuar më pas për të, por e kemi pasur këtu", - tha Rama. Më tej ai u shpreh se numri i shqiptarëve të paligjshëm në vendet e BE-së ka rënë me 27% sipas raportit të fundit të institucioneve të Brukselit, po ashtu edhe azilkërkuesit me 32%. Ndërkohë që Drejtori Ekzekutiv i FRONTEX Fabrice Leggeri, u shpreh se ky mision përveç ruajtjes së kufijve do të mbështesë policinë shqiptare edhe në një sërë detyrash të tjera siç është edhe ai për identifikimin e mjeteve të vjedhura. "Synimi i operacionit është mbështetja e kontrollit kufitar, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, terrorizimit, drogës dhe armëve. Oficerët tanë do të mbështesin, gjithashtu, zbulimin e mjeteve te vjedhura, kontrollin e dokumentacionit për emigrantët dhe çdo veprim do kryet në prani të oficerëve shqiptarë", - tha Leggeri.




Gjatë konferencës së përbashkët pas nënëshkrimit të marrëveshjes për FRONTEX

### Ministri Lleshaj: Oficerë nga 11 vende të BE do kontrollojnë kufijtë e Shqipërisë

Ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj përshëndeti nënshkrimin e marrëveshjes për fillimin e operacionit të FRONTEX ndërsa u shpreh ai do të forcojë sigurinë në kufi për ndalimin e emigrantëve që synojnë të përdorin Shqipërinë si trampolinë për të kaluar në vendet e BE-së. Në fjalën e tij gjatë kësaj ceremonie Lleshaj theksoi se tashmë kufijtë do të patrullohen me roja të përbashkëta, çka do të rrisë edhe më tej sigurinë dhe profesionalizmin në kontrollin e kufijve. "Fillimi i operacionit shënon një moment të rëndësishëm në marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në. Operacioni ka për qëllim rritjen e sigurisë së kufijve tanë. Çdo investim për më shumë siguri duhet të prodhojë më shumë liri. Angazhimi në fazën e parë të operacionit nga 11 vende të BE-së shpreh rëndësinë e madhe që i kushtohet atij. Rojet do të patrullojnë bashkë me shqiptarët për të arritur nivelin më të lartë. Personeli i shtuar, teknika moderne, standarde të reja në pikat e kalimit kufitar", - tha Lleshaj. Më tej ai theksoi se është shënuar një rritje e emigrantëve të parregullt që duan ta përdorin Shqipërinë si vend tranzit. "Në 2018 ky numër u rrit mbi 6 herë, edhe gjatë këtij viti fenomeni ka vijuar të mbetet prezent. Me FRONTEX besojmë se do të forcojmë kapacitetet në krimin ndërkufitar. Ministria e Brendshme dhe policia janë të angazhuar për suksesin e plotë të operacionit që nisim sot dhe të interesuara për zgjerimin e fushave të bashkëpunimit në luftën kundër krimit", - tha ministri Lleshaj.




Ndërkohë që Komisioneri Avramopoulis nënvizoi se dëshironte ta shihte Shqipërinë vend anëtare të BE-së. "Ky bashkëpunim është një burim krenarie si për Shqipërinë dhe BE-në dhe një hap i rëndësishëm që na bashkon. Situata në Ballkan mbetet stabël me nivele në ulje të ardhjeve, krahasuar me tri vite më parë. Jam i lumtur që tashme kemi një polici funksionale evropiane për kufirin dhe e dyta kam dashur gjithmonë ta shoh Shqipërinë sa më afër BE-së dhe vend anëtar të familjes europiane", tha Avramopoulis. Duke iu përgjigjur interesit të mediave, komisioneri Dimitris Avramopoulos komentoi vendimin e parlamentit në Holandë për kthimin e vizave me qytetarët shqiptarë. Ai pohoi se nuk dëshiron të hyjë brenda çështjeve të brendshme të një vendi anëtar të BE-së, por shtoi me siguri se në Komisionin e BE-së nuk ka arritur asnjë ankesë. "Ne nuk bëjmë komente për atë që vendoset në nivelin e vendeve anëtare, por për derisa thelbi kryesor ka të bëjë me mekanizimin për pezullimin e vizave, që ka interes të madh për ju, më lejoni t'u them se Komisioni nuk ka marrë asnjë njoftim që kërkon pezullimin e vizave për asnjë vend në Europë që përfiton. Nëse mund të ndodhë në të ardhmen, më besoni se do të bëjmë një analizë të kujdesshme nëse një veprim i tillë do të duhet të merret apo jo në përputhje me procedurat dhe informacionin që ka të bëjë me rrethanat specifike të një vendi X", - tha Komisioneri.

**FRONTEX**

"Ne do të jemi në gjendje t'u tregojmë miqve dhe partnerëve në BE edhe më mirë edhe më shumë fakte dhe prova të padiskutueshme për të qenë në këtë copëz të vogël të Europës një partner i besueshëm dhe tërësisht i besueshëm në përballimin e flukseve migratore", - tha Rama.



### Ministri gjerman: Opozita po pengon rrugën e Shqipërisë për në BE

Ministri i Shtetit për Çështjet Evropiane në Ministrinë e Jashtme Federale, Michael Roth gjatë një interviste për 'Der Spiegel', është ndalur edhe në situatën politike në Shqipëri, duke theksuar se dhuna dhe urrejtja, bojkotimi i zgjedhjeve dhe largimi i opozitës nga parlamenti janë absolutisht të papranueshme. Kreu i diplomacisë gjermane thotë se opozita shqiptare me politikën e saj penguese po rrezikon arritjet e Shqipërisë në procesin e integrimit. "Protestat janë një çështje e pranueshme sigurisht në një demokraci. Por, dhuna dhe urrejtja, bojkotimi i zgjedhjeve dhe largimi i opozitës nga parlamenti janë absolutisht të papranueshme. Shqiperia ka bërë një rrugë të gjatë për në BE. Opozita po rrezikon njohjen e këtyre arritjeve me politikën e saj penguese", - shprehet ndër të tjera Roth. Ndërkohë që ai thekson se përfshi edhe situatën në Shqipëri por edhe në gjithë Ballkanin duhet të ketë një përfshirje më të madhe të Bashkimit Europian si garantuesi më i madh i paqes në Europë. Sa i përket çështjes së hapjes së negociatave mes BE-së nga njëra anë dhe Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut nga ana tjetër, ministri gjerman thekson se jo çdo gjë duhet të varet nga zgjedhjet në Bashkimin Europian. "Ne kemi bërë zotime, tani duhet të dorëzojmë. Maqedonia e Veriut dhe Greqia kanë bërë histori me zgjidhjen e mosmarrëveshjes për emrin. Cili politikan në një shtet të BE do të guxonte të iniciojë një proces pajtimi kundër rezistencës së qartë sociale, që ishte përçmues për 28 vjet? Ne nuk mund ta bëjmë kursin e botës të varur nga datat e zgjedhjeve në BE. Afati kohor parashikohet se: Në qershor 2019, Këshilli do të vendosë. Në fund të fundit, çfarë mund të dëgjohet nga Komisioni i BE-së, kushtet janë përmbushur", - u shpreh Roth.

PROTESTA

TAKIMET

Kreu i PD-Ramës: Mos guxo! Asnjë shqiptar nuk e kursen sakrificën për liri, unë i pari

# Basha: 30 qershori tentativë për grusht shteti, e ndalim me çdo çmim

## "Shtyrja e zgjedhjeve s'cenon Kushtetutën!"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha nga Berati ku takoi strukturat e PD-së, i bëri thirrje kryeministrit Edi Rama që të shtyjë zgjedhjet e 30 qershorit duke i kujtuar se nuk është në kundërshtim me Kushtetutën. Basha paralajmëroi se nuk do të ketë zgjedhje me 30 qershor dhe se shqiptarët do ta ndalojnë me çdo çmim grushtin e shtetit. Para demokratëve të Beratit, Lulzim Basha risolli në vëmendje precedentin e 2007, kur Rama ishte në opozitë, sipas së cilit, është një tregues se nuk është kundër Kushtetutës që zgjedhjet të shtyhen. Duke e cilësuar 30 qershorin si një tentativë për grusht shteti, kryedemokrati ka ripërsëritur deklaratat e tij, se nuk do të lejojë që të zhvillohet një proces votimi fals. "Zgjedhje në 30 qershor nuk do të ketë. Grushti e shtetit do të ndalohet me çdo kusht, me çdo çmim, me çdo sakrificë. Do të mbrojmë lirinë dhe demokracinë. Paniku dhe çoroditja derdhet në çdo fjalë të Edi Ramës. Kjo tregon se çeta e tyre e shpartalluar ka humbur arsyen, qetësinë dhe e ka mbërthyer paniku. 30 qershori nuk mund të jetë ditë zgjedhjesh. 30 qershori është një tentativë për një grusht shteti kushtetues. Të çoroditurit, populli i ka futur frikën në palcë. I çoroditurit thotë nuk i shtyjë zgjedhjet, sepse nuk më le Kushtetuta. Në 2007 dy herë i shtyu zgjedhjet, sepse kërkoi që çdo votues të sillte me vete certifikatën e lindjes, kurse tani thotë nuk më lejon kushtetuta. Kundër Kushtetutës nuk është shtyrja e një procesi kriminal si ky që mendon se do të ekzekutojë në 30 qershor. Kundër kushtetutës është të emërosh kandidatë vrasës, trafikantë, përdhunues zgjedhjesh", theksoi z.Basha. Ai përmendi se "Kundër Kushtetutës është të shantazhosh dhe të kapësh drejtësinë për të mos lejuar zbardhjen e krimit elektoral të 2017. Kundër kushtetutës është të detyrosh qytetarët të shkojnë drejt një grushti shteti me 1.4 milionë karta ID false, të skaduara dhe të fusësh duart e të manipulosh regjistrin e gjendjes civile". Basha ka bërë premtimet e tij, ndonëse është kujdesur të theksojë se kjo nuk është fushatë elektorale. Duke e cilësuar 30 qershorin si një tentativë për grusht shtetit, kryedemokrati ka ripërsëritur deklaratat e tij, se nuk do të lejojë që të zhvillohet një proces votimi fals. Lulzim Basha paralajmëroi se bashkë me shqiptarët do ta ndalojë tentativën sipas tij për grusht shteti. Basha paralajmëroi kryeministrin Rama: "Mos guxo, asnjë shqiptar nuk e kursen sakrificën për liri, unë i pari". Lulzim Basha theksoi se nuk do të lejojnë zhvillimin e zgjedhjeve, ndërsa i bëri thirrje Ramës që të tërhiqet sa nuk është vonë, duke shtuar se beteja e nisur prej tyre është "betejë për jetë a vdekje". "Kam një paralajmërim të qartë për atë që bëhet gati të konsumojë veprën penale grusht shteti, mos guxo, asnjë shqiptar nuk e kursen sakrificën për liri, unë i pari. Nuk na ndalon dot, nuk e dorëzojmë demokracinë. Ju një grusht njerëzish që për përfitimet tuaja, jeni mbledhur si një grusht, nëse tentoni grushtin e shtetit më 30 qershor, do t'ju arrestojmë do t'ju dërgojmë para drejtësisë. Kjo është një betejë për jetë a vdekje. Tërhiquni sa nuk është vonë, përndryshe sovrani do t'ju gjykojë",- theksoi kreu i PD-së.


Kreu i opozitës Lulzim Basha, dje në Berati

**TENTATIVA**

"Grushti i shtetit më 30 qershor, do të ndalet me çdo kusht. Do të mbrojmë lirinë dhe demokracinë. Çeta e tyre e shpartalluar ka humbur qetësinë dhe e ka mbërthyer paniku. 30 qershori nuk mund të jetë ditë zgjedhjesh. Tentativë për grusht shtetit. Dy herë i shtyu zgjedhjet në 2007, ky që tani thotë nuk më lejon Kushtetuta",- shprehet Basha.

**PARALAJMËRIMI**

"Kam një paralajmërim të qartë për atë që bëhet gati të konsumojë veprën penale grusht shteti, mos guxo, asnjë shqiptar nuk e kursen sakrificën për liri, unë i pari. Nuk na ndalon dot, nuk e dorëzojmë demokracinë. Nëse tentoni grushtin e shtetit më 30 qershor, do t'ju arrestojmë, do t'ju dërgojmë para drejtësisë",-deklaroi z.Basha.

## 46 vjet nga revolta e Spaçit, Basha: Diktatura në fuqi, të ngrihemi ndaj së keqes

Kreu i PD, Lulzim Basha, kujtoi dje përvjetorin e revoltës së burgut të Spaçit. Në një postim në 'Facebook', Basha thotë se kjo është dita për të ftuar çdo shqiptar që të mos pranojë më asnjë diktaturë që mban peng të ardhmen tonë europiane. "Sot kujtojmë me nderimin më të thellë revoltën madhështore të Spaçit! Ato 2 ditë lirie në burgun e Spaçit ishin më të rëndësishme se e gjithë propaganda e diktaturës sepse rrëfejnë betimin e shqiptarëve për të mos pranuar asnjëherë diktaturën dhe dhunën. Ky betim është në fuqi edhe sot. Nuk ka ditë më domethënëse se 46-vjetori i revoltës së Spaçit, për të ftuar çdo shqiptar që e do Shqipërinë të lirë nga diktatura e krimit, që t'i qëndrojë besnik betimit për të mos pranuar mbi vete asnjë diktator apo karikaturë diktatori, që mban peng të ardhmen tonë europiane. Unë jam krenar që në këtë betejë, Partia Demokratike e Shqipërisë është në anën e duhur të historisë, është në nderim të vlerave për të cilat dhanë jetën heronjtë e Spaçit, është në ballë të saj për të mos bërë asnjë kompromis në rrugëtimin tonë drejt Europës. Nderim përjetë Heronjve Kryengritës të Revoltës së Spaçit! Zoti bekoftë shpirtrat e tyre dhe çdo shqiptar që ngrihet kundër së keqes!",-shprehet z.Basha.


Burgu i Spaçit



## Kryemadhi mesazh nënave: Dilni në protestë, të ndryshojmë të ardhmen

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi ftoi dje gratë shqiptarë që t'i bashkohen protestës së 25 majit në Tiranë. Sipas saj po pati shumë gra në protesta ka energji dhe jetë. "Pjesa më e madhe e komisionerëve të LSI-së, do të jenë gra. Pse gra? Gratë as nuk shiten, as nuk blihen. Gratë e LSI-së janë elementi më luftarak që ka LSI-ja. Nuk do guxojë dot njeri t'i prekë vajzat tona as me ligj dhe kanun. Aty ku Edi Rama nuk njeh vlerat dhe moralin mos të çuditet kur shqiptarët t'i tregojnë vlerat dhe moralin. Çdo ditë që ikën është dhimbje për të dhe më shumë se për Edi Ramën është dhimbje për shqiptarët. Ne do punojmë për të dalë të gjitha në 25 maj, siç jemi me gratë tona, vajzat tona, komshijet tona për t'i dhënë fytyrën e nënave. Janë nënat ata që do ta ndryshojnë këtë realitet të hidhur. Prandaj, le ta marrin fatin në dorë dhe të luftojmë për të ardhmen e fëmijëve tanë. Jam e bindur se angazhimi juaj si strukturë e LGI-së do të shtrihet në çdo protestë "-theksoi zj.Kryemadhi.

**PETRIT VASILI**

Nënkryetari i LSI Petrit Vasili reagoi dje kundër vendimeve të marra së fundmi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. "Disa vendime të saj të paligjshme janë aq të trasha në militantizmin e tyre sa që janë njëherazi edhe tragjike, por edhe komike",- shprehet Vasili.

## Ministria e Financave i premton biznesit

# Denaj: Negocim tarifave të skanimit dhe të Rrugës së Kombit




Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, e pranishme në takim garantoi bizneset në të dyja anët e kombit se asgjë nuk është e panegociushme. Ajo premtoi se do të përfshihet në bisedime me kompanitë që zotërojë këto koncesione, në mënyrë që të lehtësohen barrierat si në drejtim të skanimit, ashtu edhe për taksën në Rrugën e Kombit për bizneset e Kosovës. Përsa u përket barrierave tarifore dhe procedurale në kufi gjatë procesit të zhdoganimit, Denaj tha se është në implementim një platformë elektronike në doganë, që do ta lehtësojë më tej procesin. Një biznesi nga Shqipëria që eksporton në Kosovë i duhet të harxhojë vetëm për një procedurë 276 euro. Sipas një studimi që është bërë nga Qendra Shqiptare e Eksporteve, në këtë shumë 30 euro shkojnë për Agjencinë Doganore, 40 euro janë pagesë terminali, 68 euro kushton certifikata fitosanitare (ku 28 euro është pagesa standarde për 20 tonë plus 2 euro të tjera për çdo tonë). Ndërsa 138 euro të tjera janë pagesa për tarifat e hyrjes në rastin e një kamioni. Terminimi në Kosove i kushton një kamioni nga Shqipëria 40 milionë euro. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj premtoi dje se Kosova do të heqë tarifën e terminimit që paguajnë bizneset shqiptare në Kosovë. Ndërsa bizneseve të Kosovës u kushton një procedurë eksporti me Shqipërinë mesatarisht 170 euro. Në këto pagesa, 26 euro është tarifa e Rrugës së Kombit, 25 euro bizneset i Kosovës i paguajnë Agjencisë Doganore, 10 euro është pagesa e terminalit, 15 euro certifikata fitosanitare, 22 euro tarifa e skanimit në Shqipëri dhe 71 euro në total janë tarifat e hyrjes dhe shërbimet për një kamion në ditë. Struktura e tarifave ndërmjet doganës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës krijohet më së shumti nga disa tarifa ekstra, që vendet aplikojnë dhe më së shumti dhe nuk janë tarifa klasike doganore. Një tarifë e tillë në territorin e Kosovës është parkimi, i cili shkon 40 euro për kamion, edhe nëse bizneset e përdorin atë vetëm për një orë. Kjo tarifë është në vullnetin e qeverisë së Kosovës që të lehtësohet dhe nuk hyn në procedurat e zhdoganimit. Për një biznes nga Kosova, që do të eksportojë në Shqipëri, më së shumti peshon tarifa e skanimit prej 22 eurosh, që është një shërbim ekstra nëpërmjet koncesionit privat dhe pagesa 26 euro në Rrugën e Kombit. Shqipëria renditet e dyta pas Serbisë për barrierat më të larta tregtare ndaj Kosovës, sipas një studimi të Bankës Botërore, që u referohet të dhënave të tregtisë ndërmjet vendeve të CEFTAS. Disa nga barrierat që u evidentuan sot në Forumin Ekonomik mbarë shqiptar të mbajtur në Tiranë kanë të bëjnë më së shumti me tarifat e larta që vijnë nga skanimi në dogana dhe tarifat e larta në Rrugën e Kombit.

## Prona, pengesë për investimet, Dhoma Amerikane: Penalizon ekonominë

# Lame: 2.5 mln pasuri janë regjistruar me probleme

## *Kreu i Kadastrës: Reformë e plotë në 3 drejtime*

Ornela Manjani

Mbi 2/3 e pronave të regjistruara në Shqipëri rezultojnë me probleme. Drejtori i Agjencisë së Kadastrës, Artan Lame, se tha se 2.5 milionë prona janë për t'u rimatur. Ndërkohë, rreth 600 mijë prona të tjera janë të paregjistruara, pjesa dërrmuese pasuri shtetërore dhe gati i gjithë bregdeti i jugut. Do të jetë Kadastra që do të nisë një tjetër projekt për azhurnimin e sipërfaqeve të tokave, që u janë kthyer pronarëve apo që janë dhënë prej komisioneve të ndarjes së pronave. Gjatë një takimi me Dhomën Amerikane të Tregtisë dhe bizneset, Artan Lame ka theksuar se 2.5 mln pasuri të patundshme që ndodhen në Shqipëri janë regjistruar me probleme, ndërsa 600 mijë të tjera nuk janë regjistruar ende". 3.8 milionë pasuri janë regjistruar dhe rreth 600 mijë janë të paregjistruara, por nga këto 3.8 milionë pasuri të regjistruara, rreth 2.5 milionë janë të regjistruara me probleme", - thotë Lame. Përballë problemeve dhe sfidave, Artan Lame thotë se zgjedhjet janë tri. "E para, unifikimi i institucioneve, e dyta përmbyllja e të gjitha proceseve tranzitore, ndërsa hapi i tretë është reformimi i ZRPP", - deklaroi kreu i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Problemet me pronat dhe vështirësitë që hasin investitorët e huaj u evidentuan edhe nga Dhoma Amerikane e Tregtisë. "Çështja e pronave mbetet një nga çështjet më të vështira, por me një ndjeshmëri të lartë për komunitetin e biznesit", - deklaroi Artan Lame.

**TAKIMI**

Për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të pronësisë, BE-ja do të japë 15 mln euro. Drejtori për ekonominë në delegacionin e BE-së në Tiranë është shprehur se projekti do të nisë prej vitit 2020. Problemet e shumta që bart çështja e pronave në Shqipëri është kthyer në një shqetësim për biznesin dhe një pengesë reale për investime. Në një takim me kreun e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Dhoma Amerikane e Tregtisë e listoi zgjidhjen e çështjes së pronës si një prej pesë prioriteteve kryesore të punës së saj në Shqipëri. Nga ana e tij, Lame pranoi se problematika e pronave mbetet 'thembra e Akilit' për ekonominë shqiptare. Ai bëri një pasqyrë të gjatë të zhvillimeve që kanë shkaktuar problematikat dhe shpjegoi tri drejtimet kryesore, ku po bazohet reforma e thellë në çështjen e pronës në vend. Ato janë unifikimi i institucioneve dhe legjislacionit, mbyllja e proceseve tranzitore dhe reformimi i plotë i Zyrave të Regjistrimit të Pasurive. Në takim morën pjesë një numër i madha bankash tregtare, duke nënvizuar pengesat që sjell çështja e pronës në kreditimin e ekonomisë. Agjencia e Kadastrës Shtetërore do të ketë tri prioritete: reformë thelbësore në hartografi, reformë thelbësore në sisteme shërbimi dhe reformë thelbësore në burime njerëzore. Kjo agjenci do të jetë institucioni përgjegjës për administrimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme, si dhe për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë.



Drejtori i Agjencisë së Kadastrës, Artan Lame

**TOKA**

Paralelisht po zhvillohen disa procese për hipotekimin e pasurive të paluajtshme, regjistrimi i tokave të kthyera nga Komisionet e Kthimit të Pronave, ato të dhëna me ligjin 7501 dhe procesi i legalizimit.

## VENDIMI



### Bujar Leskaj rikthehet sërish në krye të KLSH-së

Bujar Leskaj rikthehet në krye të Kontrollit të Lartë të Shtetit, deri në momentin kur ai nuk do të zëvendësohet nga një drejtues i ri. Kreu i KLSH-së ka firmosur sot heqjen dorë nga delegimi i kompetencave të zëvendëskryetarja e KLSH-së, Lindita Lati Milo. Në vendimin e firmosur nga Bujar Leskaj theksohet fakti se zv.kryetarja e KLSH-së, Lindita Lati Milo është tërhequr nga ushtrimi i kompetencave të kryetarit për arsye personale. Ndërkohë që Leskaj thekson se për të garantuar vijueshmërinë e punës, do të qëndrojë në këtë funksion deri në zëvendësimin e tij. "Pas kërkesës për tërheqje nga kompetencat e deleguara të zv.kryetares, znj. Lindita Milo për arsye personale, dt. 21.05.2019, nr. 347, dhe garantimit të vijueshmërisë normale të punës. Në kushtet e zgjatjes në kohë të nominimit dhe përzgjedhjes së kryetarit të ri të KLSH-së, sipas përcaktimeve të Ligjit 154/2014".

# Ahmetaj: Përfitimet e minatorëve dhe ligji i ri
# Ulet mosha e pensionit, rriten përfitimet

Minatorët, naftëtarët dhe metalurgët do të përfitojnë ulje të moshës së daljes në pension dhe rritje të përfitimeve. Drafti është diskutuar në Komisionin e Ekonomisë. Kreu i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj, ka bërë të ditur përfitimet shtesë të profesioneve të veçanta, minatorët, naftëtarët dhe metalurgët. Ky projektligj synon të mbulojë me përfitim përpara mbushjes së moshës për pension dhe përfitime shtesë mbi ato që akordohen në ligjin aktual për këto tri kategori. "Së pari, mosha e daljes në pension parashikohet: për minatorët 55 vjeç, ose 10 vite para moshës ligjore të daljes në pension; për naftëtarët dhe metalurgët 60 vjeç, ose 5 vite para moshës ligjore të daljes në pension. Së dyti, parashikohet një shtesë mbi pension për minatorët, 1% të pensionit të pleqërisë për çdo vit pune në nëntokë dhe për naftëtarët e metalurgët 0,6% e pensionit për çdo vit pune në këto profesione. Bazuar në vjetërsinë e punës, minatorët përfitojnë një shtesë mbi pension minimalisht 12.5% dhe naftëtarët e metalurgët 12%. Në terma absolutë për pensionistët aktualë, kjo shtesë llogaritet në 2900 lekë në muaj, kurse për ata të rinj, edhe 1400 më tepër, si rezultat i uljes së moshës së daljes në pension. Së fundi, koeficienti i kthimit të kontributeve është 340% për minatorët, 157% për naftëtarët dhe metalurgët. Pra, për çdo lek kontribut, minatorët përfitojnë 3.4 lekë dhe naftëtarët e metalurgët 1.57 lekë", - sqaron ish-ministri i Financave, Arben Ahmetaj, në një status në 'FB'.



"Autorët na terrorizuan gjatë natës me 20 plumba, disa prej tyre depërtuan brenda në banesë"

# Sulmohet me breshëri kallashnikovi banesa e punonjësit të Bashkisë së Selenicës

## *Xhulio Mara rrëfen tmerrin: S'kam konflikte me askënd*

VLORË

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me breshëri kallashnikovi mbi banesën e shefit të shërbimeve publike në Bashkinë e Selenicës, Xhulio Mara. Mësohet se pavarësisht se janë derdhur 20 plumba drejt shtëpisë së 26-vjeçarit, fatmirësisht nuk ka persona të lënduar. "Më datë 21.05.2019, rreth orës 01:00, në rrethana ende të paqarta është qëlluar me armë zjarri në pjesën e jashtme të murit të banesës së 26-vjeçarit Xh.M., në Selenicë. Nga të shtënat nuk ka persona të lënduar. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje ku po kryen veprimet e mëtejshme hetimore në lidhje me identifikimin dhe kapjen e autorit", - njoftoi ditën e djeshme policia. Mësohet se gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes është konstatuar se në murin rrethues, por edhe pjesët e tjera janë gjetur shenjat e plumbave që zbrazën nga armët autorët. Mara është person pa precedentë penalë dhe prej tri vitesh punon në Bashkinë e Selenicës, që drejtohet nga Përparim Shametaj i zgjedhur nga PD-ja. Ndërkaq, në lidhje me këtë ngjarje ka folur edhe i riu, i cili ka deklaruar për "Gazeta Shqiptare" se autorët kanë zbrazur 20 plumba drejt shtëpisë së tij. Ai ka treguar se plumbat kanë depërtuar edhe në banesë, ndërsa shton se nuk ka pasur konflikt me asnjë person. "Më kanë qëlluar me rreth 20 plumba drejt banesës. Plumbat kanë hyrë edhe brenda në banesë. Nuk kam konflikte, s'kam pasur kërcënime më përpara", - deklaroi Xhulio Mara. Menjëherë pas sinjalizimit për sulmin me armë mbi banesën e familjes Mara, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve, si dhe zbardhjen e motivit të krimit. Mësohet se përveç pistës së paralajmërimit, po kryen hetime edhe në pista të tjera në lidhje me ngjarjen që terrorizoi familjen Mara, por edhe fqinjët e tij pas mesnate. Kjo është e disata ngjarje që regjistrohet në Vlorë pas dy atentateve pak ditë më parë, që ende nuk janë zbardhur.



Shefi i shërbimeve publike në Bashkinë e Selenicës, Xhulio Mara




### DEKLARATA E XHULIO MARËS

Në lidhje me ngjarjen e djeshme ka folur shefi i shërbimeve publike në Bashkinë e Selenicës, Xhulio Mara. Ai ka deklaruar për "Gazeta Shqiptare" se autorët kanë zbrazur 20 plumba drejt shtëpisë së tij. Ai ka treguar se plumbat kanë depërtuar edhe në banesë, ndërsa shton se nuk ka pasur konflikt me asnjë person. "Më kanë qëlluar me rreth 20 plumba drejt banesës. Plumbat kanë hyrë edhe brenda në banesë. Nuk kam konflikte, s'kam pasur kërcënime më përpara", - deklaroi Xhulio Mara.

## Operacioni "Vol-Vo 4", përfundon në pranga një tjetër person i kërkuar

**DURRËS** - Ndalohet një tjetër person i shpallur në kërkim në kuadër të operacionit "Vol-Vo 4". Sipas bluve, në pranga ka rënë shtetasi Mario Zeqiri 36 vjeç, banues në lagjen "Kodër", në Sukth të Durrësit, i cili akuzohet për veprat penale "Trafikim i narkotikëve", "Grup i strukturuar kriminal" si dhe për "Pastrim të produkteve të veprës penale". Ndaj tij është caktuar masa e sigurisë "arrest me burg" në mungesë. "Pas informacioneve të marra dhe një pune të mirorganizuar, u bë kapja dhe ndalimi i shtetasit të shpallur në kërkim më datë 22.10.2018, në kuadër të operacionit policor të koduar 'Vol-Vo 4' dhe konkretisht shtetasin: M.Z.,36 vjeç, banues në lagjen Kodër, Sukth, Durrës. Shtetasi M.Z. ishte i shpallur në kërkim, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, në datë 22.10.2018 ka vendosur ndaj tij masën e sigurimit 'Arrest me burg' për veprat penale 'Prodhim dhe shitja e narkotikëve', 'Trafikim i narkotikëve', 'Grup i strukturuar kriminal' si dhe 'Pastrimi i produkteve të veprës penale'. Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprime të mëtejshme", thuhet në njoftimin e policisë.






## Policia parandalon sherrin me armë, tre persona në pranga

**ELBASAN** - Policia e Elbasanit ka parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti, që mund të shoqërohej me pasoja të rënda për jetën. Në pranga kanë përfunduar tre persona. Mësohet se njëri prej tyre ka kanosur me armë një shtetas, ndërsa dy të tjerët janë kapur për moskallëzim krimi. Gjithashtu, është sekuestruar në cilësinë materiale një armë dhe disa fishekë. "Policia e Elbasanit ka marrë njoftimin se në fshatin Bradashesh të Elbasanit po ndodh një konflikt, ku njëri prej tyre ka dhe armë zjarri. Vlerësimi i situatës dhe reagimi në kohë i shërbimeve të policisë bëri të mundur parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit, ku njëri prej shtetaseve të përfshirë në konflikt po kanoste me armë zjarri një shtetas tjetër. Gjatë ndërhyrjes për parandalimin e konfliktit, policia kapi në flagrancë me armë zjarri pistoletë shtetasin S.Ll., 25 vjeç, banues në Elbasan, i cili gjatë një konflikti për motive të dobëta ka kanosur me armë zjarrit shtetasin F.C.. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar një armë zjarri tip 'Zastava' me 5 fishekë. Gjithashtu, janë arrestuar edhe shtetasit E.Q., 22 vjeç dhe F.B., 53 vjeç, të dy banues në Elbasan për veprën penale moskallëzim i krimit. Materialet iu kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprat penale 'Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve luftarake', 'Kanosje' në ngarkim të shtetasit S.LL., si dhe për veprën penale 'Moskallëzimi i krimit', në ngarkim të shtetaseve E.Q. dhe F.B..

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQERUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shtypje e monedhës metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '50 Lekë' pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,842,440 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi te keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shtypje e monedhës metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '50 Lekë' pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 24 Qershor 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**Nga ana e Shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk eshte shpallur ankandi faza e dyte per pasurine e meposhtme:**

**1-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 5,960 m2 dhe me siperfaqe ndertese 502 m2 me numer pasurie 28/39 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.972 date 30.12.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571,Volumi 15 Faqe 62 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 616,000 (gjashteqind e gjashtembedhjete mije) Euro.**

**2-"Truall "** me siperfaqe 4,730 m2 me numer pasurie 28/70 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.973 date 30.12.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571, Volumi 18 Faqe 143 me adrese Lushnje .
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 185,416 (njeqind e tetedhjete e pese mije e katerqind e gjashtembedhjete) Euro.**

**3-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 2,400 m2 dhe me siperfaqe ndertese 840 m2 me numer pasurie 28/58 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.653 date 25.10.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571 ,Volumi 15 Faqe 235 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 308,350.56 (treqind e tete mije e treqind e pesedhjete pike pesedhjete e gjashte) Euro.**

**4-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 4,500 m2 dhe me siperfaqe ndertese 1,535 m2 me numer pasurie 28/69 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.431 date 21.06.2013 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571 ,Volumi 18 Faqe 142 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 884,800 (teteqind e tetedhjete e kater mije e teteqind) Euro.**

**Ankandi do te zhvillohet ne date 12.06.2019 ne oren 16:00 prane zyres se shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk me Permbarues Gjyqesor Privat Admir Beqiri te ndodhur ne adresen Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.1Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane.**

### Mes të arrestuarve, dy policë dhe një inspektor

## Lejuan ndërtimet pa leje në zonën e Velipojës, SHÇBA vë në pranga pesë persona

**VELIPOJË** - Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) në bashkëpunim me Prokurorinë e Shkodrës ka arrestuar pesë persona, të cilët dyshohen se kanë lejuar disa ndërtime pa leje në zonën e Velipojës. Mes të arrestuarve janë edhe dy punonjës policie. Mësohet se pas një hetimi disamujor me metoda pro-aktive janë goditur disa zyrtarë e shtetas që dyshohet se favorizonin ndërtimet pa leje kundrejt shpërblimit financiar në zona të shpallura të mbrojtura në Velipojë. Sipas SHÇBA-së, pesë të arrestuarit akuzohen për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Korrupsionit pasiv nga persona që



ushtrojnë funksione publike". Burimet e mësipërme sqaruan se në zbatim të vendimit të gjykatës, e cila ka caktuar masën "Arrest në burg" janë arrestuar shtetasit P.Z., me detyrë specialist në Hetimin e Krimeve, në Stacionin e Policisë Velipojë; R.B., me detyrë SPZ, në Stacionin e Policisë Velipojë; R.K., me detyrë inspektor i Policisë Ndërtimore në Bashkinë Shkodër. Gjithashtu, janë ndaluar edhe 2 shtetasit: N.K., 45 vjeç, nga Mali Jushit, Shkodër dhe B.N., 37 vjeç, nga Velipoja. Sipas burimeve të mësipërme, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke keqpërdorur atributet që u jepte detyra, punonjësit e policisë dhe ai i IMT-së dyshohet se kanë lejuar që në zonën e Velipojës (e klasifikuar si "Zonë e mbrojtur") të kryhen ndërtime pa leje në masë. Nga veprimet hetimore të kryera është dokumentuar me prova ligjore veprimtaria e kundraligjshme për funksionarët publik dhe dy shtetasit. Ndërkaq, SHÇBA ka falënderuar dhe nxit qytetarët të denoncojnë çdo rast abuzimi me detyrën të punonjësve të policisë, duke telefonuar në numrin falas 0800 90 90, duke garantuar reagim të shpejtë dhe të ashpër ligjor.



### Petrit Fusha dha dorëheqjen në shkurt, pasi u njoh me hetimin 1-vjeçar kundër tij

# Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dërgon në prokurori ish-kreun e akuzës së Tiranës

**TIRANË**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka referuar në prokurori për hetim penal dosjen ndaj ish-kreut të Prokurorisë së Tiranës, Petrit Fusha, i cili dha dorëheqjen për t'i shpëtuar procesit të vetingut. Nëpërmjet një njoftimi të shkurtër për shtyp, KPK njoftoi të martën se ka referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, raportin me rezultatet përfundimtare të hetimit administrativ për ish-prokurorin Petrit Fusha.

Ish-drejtuesi i Prokurorisë së Tiranës dha dorëheqjen në shkurt, pasi u njoh me rezultatet e hetimit 1-vjeçar kundër tij nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke i kursyer vetes ballafaqimin me barrën e provës. Në njoftimin e dorëheqjes, Petrit Fusha shprehej se "pas 32 viteve pune në shërbimin e prokurorisë, çmoj se përvojën që kam mund ta përdor në dobi të një aktiviteti tjetër me më pak ngarkesë. Koha në të cilën po jetojmë është tejngarkuar me ngjarje e fenomene të drejta e të padrejta". Fusha dha dorëheqjen një ditë pasi Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i ka dërguar rezultatet e verifikimit si dhe ka kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të KPK. Ndërkohë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit e nisi procesin e vetingut për Petrit Fushën në janar të vitit 2018 dhe e përfundoi hetimin kryesisht në shkurt 2019. Petrit Fusha ka ushtruar detyrën e prokurorit nga viti 1997 deri më 28 shkurt 2019, kur vendosi të largohej me dorëheqje nga sistemi. Ai ka punuar në Prokurorinë e Tiranës për një periudhë 15-vjeçare dhe u emërua drejtues i kësaj prokurorie në vitin 2013. Në vitin 2017, Fusha u transferua në Prokurorinë e Përgjithshme. Pas vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për mbarimin e statusit të magjistratit, edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi të ndërpresë procesin e vetingut për Fushën, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.



Ish-kryeprokurori i Tiranës, Petrit Fusha

**DORËHEQJA**

Në njoftimin e dorëheqjes, Petrit Fusha shprehej se, "pas 32 viteve pune në shërbimin e prokurorisë, çmoj se përvojën që kam mund ta përdor në dobi të një aktiviteti tjetër me më pak ngarkesë. Koha në të cilën po jetojmë është tejngarkuar me ngjarje e fenomene të drejta e të padrejta". Fusha dha dorëheqjen një ditë pasi Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i ka dërguar rezultatet e verifikimit si dhe ka kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të KPK-së.



## Të kërkuar për vjedhje me armë në Itali, kapen dy persona

**DURRËS** - Policia e Durrësit ka finalizuar operacionin e koduar "Hijet e natës" duke arrestuar dy persona të shpallur në kërkim ndërkombëtar, të kërkuar nga drejtësia italiane për "Vjedhje me armë". Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë Qendrore Hetimore në Departamentin e Policisë Kriminale dhe Interpol Tirana, pas një pune të mirorganizuar, bënë kapjen dhe arrestimin e përkohshëm me qëllim ekstradimin drejt Italisë të shtetasit A.M., 25 vjeç, banues në fshatin Manzë, Durrës. Ky shtetas ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga ZQK Interpol Tirana, pasi Gjykata e Firences në Itali ka lëshuar urdhër arresti ndaj tij në korrik 2018 për kryerjen e veprave penale "Vjedhja me armë", "Vjedhja" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga Kodi Penal Italian. Gjithashtu, në kuadër të këtij operacioni u arrestua dhe shtetasi B. M., 23 vjeç, banues në fshatin Manzë, Durrës. Ky shtetas ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga ZQK Interpol Tirana, pasi Gjykata e Firences në Itali ka lëshuar urdhër arresti ndaj tij në korrik 2018, për kryerjen e veprës penale "Vjedhja me armë", parashikuar në Kodin Penal italian. Materialet hetimore u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprime të mëtejshme.

## Shisnin heroinë, prangoset 24-vjeçari dhe shpallet në kërkim i vëllai

**DURRËS** - Një 24-vjeçar me banim në Durrës është arrestuar ditën e djeshme për trafik të lëndëve narkotike, ndërsa i vëllai, i cili e ndihmonte në veprimtarinë e paligjshme, është shpallur në kërkim. Kapja e të riut është bërë pasi u dokumentua veprimtaria e tij e paligjshme në shpërndarjen e heroinës në doza të vogla, sipas porosive që bënin klientët. "Seksioni për Hetimin e Narkotikëve arrestoi në flagrancë shtetasin H.P., 24 vjeç, banues në Shijak. Arrestimi i tij u bë pasi ky shtetas ishte në vëzhgim dhe në ndjekje nga shërbimet e policisë, sepse



për të disponohej informacion se në bazë të porosisë shpërndante lëndë narkotike të llojit heroinë në formë dozash. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se ky shtetas e kryente këtë veprimtari të kundraligjshme në bashkëpunim me vëllain e tij shtetasin A.P., 28 vjeç, banues në Shijak, i cili u shpall në kërkim. Shërbimet e policisë kapën në flagrancë shtetasin H.P., në vendin e quajtur "4 Rrugët e Shijakut", duke i shitur disa doza heroinë shtetasit O.A., 35 vjeç, (përdorues) dhe nga kontrolli i ushtruar në automjetin e tij u gjetën 3 doza lëndë narkotike e llojit heroinë, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Materialet hetimore u kaluan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprime të mëtejshme", thuhet në njoftimin e policisë.

**NJOFTIM ANKANDI**

1. **Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k** njofton Shpalljen e Ankandit të III (Tretë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme: Njësi, me sip. 142 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 496/386+3-N2, Vol. 52, Faqe 239, ndodhur në Linzë Dajt, Tiranë, në pronësi të: Shoqërisë "AGLI" shpk identifikuar me NIPT J71702004M. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **4,465,843 (katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet e tre) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **24.05.2019, ora 16:00,** pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k , në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, shpërndahen tapitë dhe paratë e kompensimit

# VKM, lista me 2 mijë pronarët që marrin tapitë

## Kompensohen pronarët, 230 milionë lekë për 510 përfitues

Ornela Manjani

Rreth 2 mijë persona që kanë ndërtuar pa leje do të marrin tapitë për truallin. Ndërkohë, 510 pronarëve të cilëve u është zënë toka nga këto ndërtime do të kompensohen. Vlera e parave që do të përndahet për përfituesit është rreth 230 milionë lekë. Vendimi është marrë këtë të mërkurë nga qeveria dhe do të zbatohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila do të pajisë me certifikatë pronësie 2 mijë përfituesit në 12 qarqe të vendit. Ndërkohë që fondi prej 230 milionë lekësh do të shpërndahet nga Agjencia e Trajtimit të Pronave. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e tapive dhe sipërfaqet takuese për secilin dhe listën me pronarët që kompensohen së bashku me shumën e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

**VENDIMI**

Qeveria miratoi kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të subjekteve përfituese për 1 205 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre, ku përfitojnë rreth 2 mijë familje. Përfituesit janë në qarkun Berat, Qarkun Elbasan, Qarkun Durrës, Qarkun Tiranë, Qarkun Fier, Shkodër, Vlorë, Gjirokastër, Kukës dhe Korçë. Sipas vendimit të qeverisë, masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas ZVRPP-së është 33 964,81 m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 229 092 338 lekë. Qeveria ngarkon zyrat vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Elbasan, Librazhd, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Kavajë dhe Kukës të regjistrojnë brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to, në përputhje me përcaktimet e pikave 15 e 16, të vendimit nr.1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara".

| Nr. rendor | Të dhënat e Pasurisë | | | Sipërf aqj a për |
|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 9 |
| QARKU VLORE , ZONA KADASTRALE 3140 ZVRPP | | | | |
| 1048 | ANESTI | THOMA | QARRI | 400 |
| 1049 | ERALDO | ANESTI | QARRI | 400 |
| QARKU VLORE , ZONA KADASTRALE 8604 ZVRPP | | | | |
| 1050 | MITAT | FERIK | ISAJ | 78 |
| 1051 | KOSTA | TASI | GERVENI, | 189 |
| | DALMA | KOSTAQ | GERVENI | |
| 1052 | KOÇO | KRISTAQ | BAKA | 243 |
| 1053 | ARDIT | ISUF | BYLO | 369 |
| 1054 | VIOLET | OSMËN | BYLO | 201 |
| 1055 | AGIM | SERI | ZINXHIRIA | 233 |
| 1056 | KRESHNIK | SKENDER | MALIQI | 282 |
| 1057 | ARBEN | FETAH | DRIZA | 306 |
| 1058 | DORJA | NAMIK | SULLAJ | 296 |
| 1059 | HYSEN | SHEFQET | ALIKO | 342 |
| 1060 | LIGOR | JANI | BIBA | 59 |
| 1061 | SULEJMA | MASK | TOZAJ | 357 |
| 1062 | FEKO | TEFIK | XHENGO | 333 |
| 1063 | KASTRIO | ALIKO | HODAJ | 12 |
| | ZYBË | IMER | RYSTEMI, | |
| | MAKSI | SKËNDER | RYSTEMI | |
| | MARTIN | SKËNDER | RYSTEMI | |
| 1064 | BRUNILD | SKËNDER | RYSTEMI | 438 |
| 1065 | SAIMIR | MITAT | HALILI | 78 |
| 1066 | JANI | NJAZI | ÇOLLAKU | 302 |
| 1067 | ILIR | DRIT | CAUSHI | 169.4 |
| 1068 | PAJTIM | BARJAM | HANAJ | 369 |
| 1069 | AGIM | AXHEM | SEJDIRAJ | 141 |
| 1070 | NASIBI | SERRIK | LIÇENJI | 363 |
| 1071 | BEHIJE | VEIS | SELAMAJ | 182 |
| 1072 | HAXHI | AHMET | HAMETI, | 366 |
| | BRAHIM | AHMET | HAMETI | |
| 1073 | MINELL | GORI | JANKO | 330 |
| 1074 | VASILL | VLLASI | DHAMO | 6 |
| 1075 | EQEREM | HADIL | HYSENI | 222 |
| 1076 | ERVIN | THOMA | VERAJ | 42 |
| 1077 | JANI | VEIS | BRAÇELLARI | 341 |
| 1078 | OLJAN | FADIL | BASHLLARI | 490 |
| 1079 | SUZAN | DRIT | SHEHU | 174 |
| 1080 | GJERGJI | RAMADAN | HOXHA | 443 |
| 1081 | REMZI | SHEFQET | ALIKO | 500 |
| | MANUSH | XHAFER | ABAZI | |
| | ,MEZAN | SAFET | ABAZI | |
| | ARIELA | SAFET | ABAZI | |
| | ARBI | SAFET | ABAZI | |
| 1082 | LENJA | SAFET | ABAZI | 300 |
| 1083 | ELIGERT | ËNGJËLL | MALUSHAJ | 171 |
| QARKU VLORE , ZONA KADASTRALE 1952 ZVRPP | | | | |
| 1084 | STAVR | VASIL | MARAÇI | 305 |

| Nr. rendor | Të dhënat e Pasurisë | | | Sipërf aqj a për |
|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 9 |
| QARKU VLORE , ZONA KADASTRALE 2863 ZVRPP | | | | |
| | MARINEL | GANI | KOSTAJANI, | |
| | VASILIK | PIRO | KOSTAJANI | |
| 1085 | KATHERIN | PIRO | KOSTAJANI | 199 |
| QARKU VLORE , ZONA KADASTRALE 8605 ZVRPP | | | | |
| 1086 | TEKI | TEFIK | ÇELA | 248.4 |
| QARKU VLORE , ZONA KADASTRALE 8605 ZVRPP | | | | |
| 1087 | QERIM | ISMAIL | HYSA | 358 |
| 1088 | LUTFI | SHABAN | CANI | 252 |
| | FATMIR | XHELIL | HASANI | |
| | MUHAM | XHELADIN | KAPAJ | |
| | SOKRA | XHEZMI | SINANAJ | |
| | NAZIF | SAKO | SINANAJ | |
| | KUJTIM | NAZIF | SINANAJ | |
| | STAVRI | MALIQ | BERDELLIMA | |
| | MONDI | FERIT | TAHIRLLARI | |
| 1089 | VEZIRE | QAZIM | BERDELLIMA | |
| | PETRIT | MALIQ | BERDELLIM | |
| | XHEVAI | SHABAN | CANI | |
| QARKU VLORË, ZONA KADASTRALE 2863 , ZVRPP | | | | |
| 1090 | LLUKA | KOÇO | PETROMILO | 500 |
| | IVA | LLUKA | SESERI | |
| DREJTORIA E ALUIZNI-t GJIROKASTER | | | | |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2461 , | | | | |
| 1091 | MINA | SPIRO | DHAMO | 379.0 |
| 1092 | LEONA | ARIF | AHMETI | 309.0 |
| 1093 | YLLI | HYSEN | TELHAI | 309.0 |
| 1094 | ODHISE | YLLI | DINE | 343.0 |
| 1095 | FASLLI | RRAMAN | DELILAJ | 309.0 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1234 | | | | |
| 1096 | ILIA | MIHAL | KUCO | 429 |
| 1097 | KRISTO | KRISTO | PAPA | 432 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2007 | | | | |
| 1098 | NIKOLLA | VASIL | PAPAILIA | 318 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2131 | | | | |
| 1099 | KRISTO | JAVER | PICARI | 7 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1292 | | | | |
| 1100 | SHPËTIM | SALI | BENDO | 330 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2392 | | | | |
| 1101 | EDMOND | HODO | KOLI | 185 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 8543 | | | | |
| 1102 | SKËNDE | MUHO | DEMIRAJ | 480 |
| 1103 | SKËNDE | BAJO | ONJEA | 78 |
| 1104 | HEKTOR | FEJZO | SEFERI | 147 |

| Nr. rendor | Të dhënat e Pasurisë | | | Sipërf aqj a për |
|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 9 |
| 1104 | HEKTOR | FEJZO | SEFERI | 147 |
| 1105 | REXHEP | HISENJ | GJOKSI | 130 |
| 1106 | STAVR | BEZAT | MYRTEZAJ | 469.5 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 8541 | | | | |
| | DALIP, | ABAZ, | TOCKA | |
| | FIQIRETE | SHEMO | TOCKA | |
| | VOGLUS | HASKO, | HALOÇI | |
| | KRESHNIK | YLLI | HALOÇI | |
| 1107 | ,ELONA | YLLI, | HALOÇI | 36 |
| | HYSEN,, | MERSIN,, | ÇINGO | |
| | ERION | HYSEN | ÇINGO | |
| | DONIKA | TEFIK | ÇINGO | |
| | STAVRO | VIKTOR, | GJONI | |
| | ,MANTHA | ROZEL | GJONI | |
| | MANOL | FILIP | LICI | |
| | ARQILE | LLUKAN | VASI | |
| 1108 | ALTIN | HIQMET | GOXHARAJ | 22 |
| 1109 | SHPËTIM | BAJO | BOCI | 9 |
| | ENGJELL, | MERO | SEJFO | |
| | XHEMILE | ,ISUF | SEJFO | |
| | LUAN, | AVNI, | SEHITI | |
| | LULJETA | FASLLI | SEHITI | |
| | ILIRJAN | MYFTAR | ZEKAJ | |
| 1110 | ,MIMOZA | ,DULE | ZEKAJ | 43 |
| 1111 | KISMET | HYSENJ | PUTO | 9 |
| 1112 | ARTUR | TAIP | ALIKO | 140 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2956 | | | | |
| 1113 | MODERIN | ABEDIN | KOKO | 225 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1307 | | | | |
| 1114 | ALQIVIAD | JANI | XHUMBA | 321 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2131 | | | | |
| 1115 | FATMIR | SKËNDER | ÇEPANI | 350 |
| 1116 | BESNIK | RAMO | SHEHU | 135 |
| 1117 | BESNIK | RAMO | SHEHU | 328 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2646 | | | | |
| 1118 | BEKTAS | HADER | SAKO | 146 |
| 1119 | FATOS | RIZA | HYSESANI | 120 |
| 1120 | LUAN | TAIP | GOXHA | 9.5 |
| 1121 | KUJTIM | GODO | BILA | 10 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3719 | | | | |
| 1122 | HAZBI | NEKI | BETA | 120 |
| 1123 | XHEZO | GANI | CANA | 330 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2041 | | | | |
| 1124 | KUJTIM | SELMAN | RAMA | 70 |
| 1125 | ENDRI | KUJTIM | RAMA | 300 |
| QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3932 | | | | |
| 1126 | ARDIAN | SKËNDO | BEQIRI | 309 |
| | VIKTOR | SKËNDO | BEQIRI | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2260** | | | | |
| 1127 | ILIR | DEMIR | PASHA | 500 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2917** | | | | |
| 1128 | ALBAN | ASQERI | BEQARAJ | 9 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1961** | | | | |
| 1129 | PËLLUM | HYSEN | RRAPI | 214 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3574** | | | | |
| 1130 | JULIAN | VELI | XHAFERI | 115 |
| 1131 | ZYBER | FASLLI | MALAJ | 300 |
| 1132 | BASHKI | QANI | ÇIBUKAJ | 97 |
| 1133 | BUJAR | NEIM | XHANARI | 29.1 |
| 1134 | TETEM | SEFER | ALIKA | 375 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2541** | | | | |
| 1135 | DRITAN | DRAGUSH | KUCA | 306 |
| 1136 | ARKID | DRAGUSH | KUCA | 78 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE** | | | | |
| 1137 | FREDERIK | PELLUMB | MUÇAJ | 26.4 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2646** | | | | |
| 1138 | BESNIK | MIRTE | MIRTA | 41 |
| 1139 | SKENDE | HAKI | TATA | 65.3 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1025** | | | | |
| 1140 | ANDON | JANI | ZOTA | 500 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3602** | | | | |
| 1141 | KASO | XHAFER | NUKA | 40 |
| 1142 | KASO | XHAFER | NUKA | 450 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2260** | | | | |
| 1143 | HEKUR | VELI | ZYKA | 245 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2341** | | | | |
| 1144 | TOMORR | QAMIL | MINO | 270 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3524** | | | | |
| 1145 | DHIOGJEN | SPIRO | PAPA | 452 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3967** | | | | |
| 1146 | ADRIATIK | ALI | PASHO | 24 |
| 1147 | ENGJËLL | ASLLAN | KASO | 21 |
| 1148 | MEHMET | ALI | DURO | 30 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2434** | | | | |
| 1149 | HODO | SEJFULL | HODO | 318 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2917** | | | | |
| 1150 | ZENJEL | BRAHIM | JASHARI | 310 |
| | GJERGJI, | SIMO, | STEFO | |
| | LILIKA | NULI | STEFO | |
| 1151 | ARJAN | FASLLI | CANKA | 21 |
| 1152 | ILIR, | HAZBI, | KASO | 15 |
| | KLEMENTI | SKENDER | KASO | |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3057** | | | | |
| | LEONORA | MARKO,, | MEMA | |
| | ERNES, | MATO | MEMA | |
| 1153 | ENDRI | MATO | MEMA | 170 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3574** | | | | |
| 1154 | JORGO | IDAJET | TOLA | 80.3 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1234** | | | | |
| 1155 | VJOLETA | THOMA | JOVANI | 228 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2484** | | | | |
| 1156 | JORGO | MANTHJO | PAGUNA | 441 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1307** | | | | |
| 1157 | ELENI | VANGJEL | GAZHGA | 340 |
| 1158 | ELENI | MILTIADH | GJIKA | 246 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1803** | | | | |
| 1159 | FROSINA, | VASIL, | SHTAKA | 450 |
| | PETRAQ | NIKOLLAQ | SHTAKA | |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1359** | | | | |
| 1160 | FOTI | THODHORI | VLLAHO | 320 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2392** | | | | |
| 1161 | VULLNET | MURAT | MAMO | 70 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 8542** | | | | |
| 1162 | REZARTA | EQREM | RONDO | 169 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 8543** | | | | |
| 1163 | DHIMITËR | MYRTEZA | AGO | 360 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 8541** | | | | |
| 1164 | KRESHNIK | ADRIATIK | LITI | 326 |
| 1165 | GANI | METAT | XARBA | 283 |
| 1166 | LUIGJ | MINA | LUZO | 33 |
| 1167 | EQEREM | KAMBER | FEJZO | 144 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1970** | | | | |
| 1168 | LAVER | BIDO | RUKO | 96 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1592** | | | | |
| 1169 | KASTRIO | TAHIR | LLAPI | 1130 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3263** | | | | |
| 1170 | KATERIN | SIKO, | DELI | 125 |
| | ,EDMOND | KOÇO | DELI | |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2444** | | | | |
| 1171 | BASTRI | HEKURAN | BUZO | 90 |
| 1172 | KRYEGJYSHATA BOTERORE | | | 100 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2646** | | | | |
| | HAZBI, | ZENEL,, | RAKIPI | |
| | DRITË, | SHAQO | RAKIPI | |
| | KASTRIO | HAZBI, | RAKIPI | |
| 1173 | ANDON, | HAZBI | RAKIPI | 25.7 |
| 1174 | VASIL | ARIF | NASI | 48.3 |
| | BAKO, | CANO, | MEMA | |
| | ZYMBYLE | BARJAM, | ANASTASI | |
| 1175 | HEROLIND | BAKO | BAKO | 11.3 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2917** | | | | |
| 1176 | AGATHO | MISTO | PROKO | 6.8 |
| 1177 | NDREKO | STAVRO | ÇELA | 49 |
| | MANOL | NDREKO | ÇELA | |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3524** | | | | |
| 1178 | MILI | RAMADAN | JAÇE | 188 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1359** | | | | |
| 1179 | VASIL | SOTIR | KALULLI | 220 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3820** | | | | |
| 1180 | ALQI | THOMA | THEMELI | 210 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3480** | | | | |
| 1181 | KRISTAQ | KOSTA | LUFI | 12 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1476** | | | | |
| 1182 | IRAKLI | FOTO | NDRICO | 55 |
| | THEOHAR | VASIL,, | DEDE | |
| | ,NATASH | VASIL | DEDE | |
| 1183 | PANDELI | THEOHARI | DEDE | 375 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 8543** | | | | |
| 1184 | ZEQIR | REZMI | MUSTA | 445 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1053** | | | | |
| 1185 | SHEFIT,ED | SHAHIN,HILM | BENDO | 84 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 8541** | | | | |
| 1186 | BESNIK | ÇARÇIS | MANGA | 59.5 |
| 1187 | DHURIM | HILMI | BAJO | 383 |
| 1188 | BAHIR | HAREM | BIZHGA | 380 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3701** | | | | |
| 1189 | JAKUP | BARJAM | KASAJ | 100 |
| 1190 | HASAN | HODO | KLLËÇI | 28.8 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2810** | | | | |
| 1191 | MARGARI | LEFTER | MEJDI | 300 |
| 1192 | JORGO | THODHORA | GOÇE | 234 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2094** | | | | |
| 1193 | ANASTA | ILIA | SULI | 235 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2132** | | | | |
| 1194 | THOMA | POLIKRON | KOTO | 32 |
| 1195 | ISMET | QEMAL | LILE | 30.5 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3540** | | | | |
| 1196 | KRYEGJYSHATA BOTERORE | | | 153 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2781** | | | | |
| 1197 | HYSO | URHAN | VESELI | 405 |
| 1198 | VASILI | SADO | KOKOSHI | 500 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2853** | | | | |
| 1199 | KRYEGJYSHATA BOTERORE | | | 72 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2917** | | | | |
| 1200 | SPIRO | KASO | MANÇELLARI | 95 |
| 1201 | ADRIATIK | IBRAHIM | JAÇE | 18 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 3967** | | | | |
| 1204 | SPIRO | PERE | NASTO | 34.5 |
| 1203 | TEFIK | BIDO | BAKOLLARI | 25 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 1981** | | | | |
| 1204 | VIRON | THANAS | ÇIÇOLLI | 290 |
| **QARKU GJIROKASTER , ZONA KADASTRALE 2541** | | | | |
| 1205 | FLORIAN | VELO, | DAJKA, | 250 |
| | ,ILIR | GUXHË | META | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ENVER | RAMADAN | BAJGORA | 23.5 |
| LINDITA | RAHMI | BAJGORA | |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| LULZIM | XHAFERR | SINA | 277.8 |
| ARBEN | SHAHIN | KASA | 265.5 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| BAJRAM | AHMET | SHEHI | |
| EMINE | KASEM | SHEHI | |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| NEZIR | FETA | BAHO | 322.8 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| LUTFI | JAHO | ÇELA | 251.1 |
| FATI | SHEFQET | KIKIJA | 294.3 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| XHAFER | SABRI | GOSTIMA | 322.2 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| JONUZ | LIMON | SINA | 426.3 |
| GANI | ZEQIR | KULLAFI | |
| TEKI | GANI | KULLAFI | |
| BESIM | GANI | KULLAFI | 372.6 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| POLIMER | MINA | PALIS | |
| MINA | FILIP | PALIS | |
| LIRI | | PALIS | 85.2 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA** | | | |
| XHEMILE | ISUF | KOKOLI | 23.1 |
| VIOLETA | ISA | MEMA | 91.3 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA** | | | |
| XHIXHE | OSMAN | NEZHA | 201.6 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA** | | | |
| NAIM | SELIM | BOGDANI | 234.9 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA** | | | |
| ALËKSAN | NEKI | TOÇKA | 324.3 |
| NEKI | XHELO | TOÇKA | 290.4 |
| ERGYS | NEKI | TOÇKA | |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| BANUSH | GANI | MUÇA | 316.5 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| VANGJEL | SELMAN | BALLIU | 500 |
| FERIT | SALI | KULLA | 498.3 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| ARBEN | ABDULLA | HAZIZI | 222.5 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| RRAPU | DAUT | DANA | 12.7 |
| MARGARI | NAIL | SULA | 24 |
| NEKI | HABIB | ALI | 327.3 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| IZET | SALI | MEÇO | 239.7 |
| ERMIRA | ABAZ | ZELA | 246.3 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| ARBEN | BASHKIM | KUMINJA | 307.5 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| ILIR | HEKUR | HOXHA | 276 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| SERAFI | MIHAL | TOSKA | 72.5 |
| KRISTA | KOST | ÇIPI | 174.7 |
| ALEKSAN | MIHAL | ÇIPI | |
| ROZINA | KOSTANDIN | SHABANLLAR | 416.4 |
| **QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA** | | | |
| GRAMO | MERSIN | BAJRAMI | 367.8 |
| HYQME | FAIK | AHMATI | 304.8 |
| PETRIT | SHEFQET | AHMATI | 308.7 |
| BUJAR | SELIM | SOLLAKU | 203.7 |
| VJOLLC | RAMAZAN | SOLLAKU | |
| ERVIS | NOSI | KUQJA | 339 |
| TAQI | JOSIF | OGA | 296.1 |





Gjatë leksionit te hapur në analizë të viktimave të simuluara në 'Luarasi'

### Tradita e kombinimit të teorisë me praktikën, studentët: Na ndihmon për të ardhmen

# Studentët e Drejtësisë në universitetin "Luarasi", analizë të rasteve simuluese

## *Rektori Ethem Ruka: Përgatisim profesionalisht studentët*

Voltiza Duro

Praktika është një ndër elementët më të rëndësishëm në formësimin e profesionistëve të denjë për tregun e punës. Në kuadër të kombinimit të teorisë me praktikën, studentët e Drejtësisë në universitetin "Luarasi" kanë zhvilluar një orë të hapur, ku kanë analizuar viktimat e simuluara dhe vendin e ngjarjes.

**TRADITA E PRAKTIKAVE**

Ky leksion i veçantë u organizua nga pedagogu i lëndës Procedura Penale, avokati i njohur, Saimir Vishaj. Rektori i universitetit "Luarasi", prof.dr Ethem Ruka tha se nëpërmjet praktikave të tilla, studentët shfaqin më shumë interes. "Mësime të tilla të hapura, të simuluara janë të zakonshme tashmë në universitetin 'Luarasi', veçanërisht në Fakultetin e Drejtësisë. Praktikisht sot po organizohet një leksion i hapur për këqyrjen e personave të dhunuar, të plagosur etj. Ky mësim i afrohet realitetit dhe ka për qëllim që studentet tanë të drejtësisë të mësojnë, të këqyrin viktimat, por të vrasin edhe frikën psikologjikisht sepse nesër do të jenë ata që do të ndodhen në vendin e ngjarjes. Mendoj se mësime të tilla janë interesante, tërheqin vëmendjen e studentëve, e bëjnë mësimin shumë aktiv dhe përfitimi është maksimal", - tha Ruka në fjalën e tij. Ky i fundit shtoi se në këtë mënyrë studentët e "Luarasit" përgatiten maksimalisht për të ardhmen profesionale. "Qëllimi ynë është që të afrojmë sa më shumë studentët me praktikën, t'i bëjmë profesionistë që në bankat e shkollës. Praktika të tilla janë të shumta për studentët e drejtësisë si leksionet në klinikën ligjore, vizitat nëpër burgje, seancat gjyqësore të simuluara, ku të rinjtë vihen në rolin e avokatit, prokurorit e gjykatësit. Kështu do të formohen si profesionistë, pasi nesër do të jenë këta studentë që do të kenë në dorë drejtësinë", - shtoi rektori i universitetit "Luarasi".




**ETHEM RUKA**



"Praktika të tilla janë të shumta për studentët e drejtësisë si leksionet në klinikën ligjore, vizitat nëpër burgje, seancat gjyqësore të simuluara, ku të rinjtë vihen në rolin e avokatit, prokurorit e gjykatësit. Kështu do të formohen si profesionistë, pasi nesër do të jenë këta studentë që do të kenë në dorë drejtësinë", - shtoi rektori.

**SAIMIR VISHAJ**



"Studentët kanë një detyrë të rëndësishme në këtë proces, të bëjnë këqyrjen e viktimave dhe vendit të ngjarjes. Është një demonstrim profesional, ku studentët kanë mundësi të gërshetojnë teorinë me praktikën, që është edhe motoja e universitetit 'Luarasi'", - tha Saimir Vishaj.

**STUDENTJA**



"Objektivi kryesor i universitetit 'Luarasi' është gjithmonë gërshetimi i teorisë me praktikën dhe vënia në jetë e të gjithë atyre që ne mësojmë në teori. Dita e sotme është një nga shembujt më të mirë, pasi çdo gjë që kemi mësuar arrijmë ta shikojmë më nga afër", - tha njëra prej studenteve të Drejtësisë te "Luarasi".

**STUDENTI I "LUARASIT"**



"Kur të dalim në punë, do të ndeshemi me raste të tilla, por do ta kemi më të lehtë, pasi i kemi parë dhe vëzhguar që në auditorë. Kjo është një mundësi shumë e vlefshme që e ofron universiteti ynë, 'Luarasi'", - u shpreh një tjetër student.

**ORGANIZIMI**

Pedagogu Saimir Vishaj u shpjegoi studentëve rastet e simuluara dhe procedurën që duhet të ndjekin për mbikëqyrjen e tyre. "Aktualisht jemi në lëndën e Procedurës Penale, ku një nga bazat e saj është edhe Instituti i Provave. Ndryshe është ajo që ne flasim në teori, (duke mësuar se ç'është prova, çfarë është një vrasje apo marrëdhënie seksuale me dhunë) dhe ndryshe është ajo çka ne demonstrojmë sot përpara studentëve me të dëmtuar nga vepra penale. Kemi 3 raste simuluese: një vrasje, një plagosje të rëndë dhe një marrëdhënie seksuale me dhunë", - bëri me dije pedagogu i Procedurës Penale. Më tej, ai theksoi se simulime të tilla janë tejet të vlefshme për të rinjtë që aspirojnë të bëhen pjesë e sistemit të drejtësisë. "Studentët kanë një detyrë të rëndësishme në këtë proces, të bëjnë këqyrjen e viktimave dhe vendit të ngjarjes. Është një demonstrim profesional, ku studentët kanë mundësi të gërshetojnë teorinë me praktikën, që është edhe motoja e universitetit 'Luarasi'", - tha Vishaj.

**INTERAKTIVITETI**

Vetë studentët e Drejtësisë kanë shprehur interes maksimal gjatë orës simuluese. "Objektivi kryesor i universitetit 'Luarasi' është gjithmonë gërshetimi i teorisë me praktikën dhe vënia në jetë e të gjithë atyre që ne mësojmë në teori. Dita e sotme është një nga shembujt më të mirë, pasi çdo gjë që kemi mësuar arrijmë ta shikojmë më nga afër", - tha njëra prej studenteve të Drejtësisë te "Luarasi". Ndërkohë një tjetër student tregon se praktika të tilla e ndihmojnë të aftësohet më shumë për të ardhmen. "Ky leksion është shumë i rëndësishëm për ne pasi përveç teorisë, na dha mundësinë të mësojmë edhe nëpërmjet praktikës. Kur të dalim në punë, do të ndeshemi me raste të tilla, por do ta kemi më të lehtë, pasi i kemi parë dhe vëzhguar që në auditorë. Kjo është një mundësi shumë e vlefshme që e ofron universiteti ynë, 'Luarasi'", - u shpreh një tjetër student. Nëpërmjet praktikave të tilla bashkëkohore, "Luarasi" synon t'u ofrojë studentëve kushte e mundësi optimale për përgatitjen e tyre në tregun e punës. Kështu, ky universitet dëshmon edhe njëherë se vazhdon të mbetet një institucion lider për arsimin e lartë në vend, duke sjellë përvojat më të mira pranë studentëve të tij.

Qendra e Shërbimeve Arsimore: Kujdes, ja dokumentacioni që duhet të paraqisni

# Zbardhen emrat e 1606 infermierëve që do t'i nënshtrohen provimit të shtetit

## Lista e dytë e kandidatëve që do të testohen deri në 11 qershor

Voltiza Duro

Prej datës 27 maj deri në 11 qershor të këtij viti, infermierët do t'i nënshtrohen provimit të shtetit për profesionet e rregulluara në fushën e mjekësisë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e plotë me emrat e 1606 infermierëve dhe datat përkatëse të testimit. Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton të gjithë kandidatët që të paraqiten pranë godinës së këtij institucioni 30 minuta para provimit. "Për të gjithë kandidatët aplikantë për provimet e shtetit për profesionet e rregulluara të mjekut, farmacistit, stomatologut, mamisë, fizioterapistit, logopedistit, teknikut të imazherisë dhe teknikut të laboratorit, ju bëjmë me se provimi i shtetit për profesionet e rregulluara të fushës së mjekësisë do të zhvillohet nga fillimi i muajit maj 2019 e në vijim. Provimi i Shtetit do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA) me adresë bulevardi 'Zhan D'Ark', nr. 23, Tiranë (ose godina e ish-ATSH). Kandidati duhet të paraqitet në QSHA 30 minuta para fillimit të provimit të shtetit", - bën me dije QSHA.

**DOKUMENTACIONI**

Qendra e Shërbimeve Arsimore thekson se kandidatët nuk duhet të harrojnë dokumentacionin ditën e testit. "Ditën e provimit kandidati duhet të jetë i pajisur me: letërnjoftim (kartë ID ose pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti origjinal); kopje të kartë ID ose pasaportë si dhe me faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA, nga një bankë të nivelit të dytë/ postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes", - nënvizon QSHA. Kjo e fundit shton gjithashtu se fatura duhet të ketë vulën e bankës përkatëse.

EMRAT 1606 INFERMIERËVEQË DO T'I NËNSHTROHEN PROVIMIT TË SHTETIT

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 172 | Anxhela | Ylber | Llapanji | 28.05.2019 09:00 |
| 173 | Anxhela | Arben | Dashi | 28.05.2019 09:00 |
| 174 | Anxhela | Sofokli | Kurraj | 28.05.2019 09:00 |
| 175 | Anxhela | Fatos | Lamçe | 28.05.2019 09:00 |
| 176 | Anxhela | Dritan | Blacëri | 28.05.2019 09:00 |
| 177 | Anxhela | Markelian | Laçi | 28.05.2019 09:00 |
| 178 | Anxhela | Kadri | Doksani | 28.05.2019 09:00 |
| 179 | Anxhela | Ferdinant | Lime | 28.05.2019 09:00 |
| 180 | Anxhela | Ramis | Sinademi | 28.05.2019 09:00 |
| 181 | Anxhelina | Bujar | Mezini | 28.05.2019 09:00 |
| 182 | Anjeza | Rexhep | Kaçuli | 28.05.2019 09:00 |
| 183 | Anjeza | Agim | Gava | 28.05.2019 09:00 |
| 184 | Anjeza | Demir | Cufaj | 28.05.2019 09:00 |
| 185 | Apostol | Sotiraq | Xhoxhi | 28.05.2019 09:00 |
| 186 | Arban | Ylli | Hyskaj | 28.05.2019 09:00 |
| 187 | Arbana | Ramazan | Peçi | 28.05.2019 09:00 |
| 188 | Arben | Ferit | Cani | 28.05.2019 09:00 |
…filloi paraditen e një dite pa emër, pse pa emër, ishte 22 maj dhe quhet dita e revoltës së të burgosurve të Qafë-Barit? Brigadat e natës, ndërresa e tretë e të burgosurve, qenë kthyer nga puna, kishin 2-3 orë që prisnin në këmbë dhe s'jepej urdhri të shkonin në fjetore. Gjysma flinte në këmbë. Mbështetur te muri, te shoku, te shkallët, tek telat me gjemba. Vurrata të zeza nëpër fytyra, o nga të palarët, o prej tmerrit që shihnin në atë copëz ëndërr. Çfarë ka ndodhur, pse na mbajnë? Dy Nduet, Pisha dhe Nikolla, nuk kanë realizuar normën. Po pse? S'kishte material dhe s'duan të kthehen të minierë, po kundërshtojnë. E kishin gërryer materialin me lopatë, "asgja s'ka mbetun, s'lame kokërr minerali, dyshemeja ngjan si e fshime, s'ka ma, doli dhé." "Jo, - bërtiste policia, - duhet të ktheheni. Urdhër i komandës. Prapë në ndërresën e parë!" "S'kemi pse kthehemi, - këmbëngulnin të burgosurit. - Jemi të lodhur, duam të flemë, të vdesim." "S'ju lëmë të vdisni pa bërë normën." "Në darkë prapë." "Jo, tani!" "S'ka material, mor zotni, s'ishte faji ynë." "Po i kujt, yni?" - bërtisnin policët.

***

U futën nja 10-15 policë. U përhapën në krye. Pastaj u futën policë të tjerë me të burgosur të tjerë me pranga në duar ose të lidhur me tel, veshur me leckat e punës, me fytyra të nxira aq sa s'njiheshin. Ata…

Ra heshtje barbare, e cila u ça kur hyri brenda oficeri i rojës. Si zakonisht, nuk përshëndeti, s'kishte pse. "Ce s'e betë normën (j)uve, të denuar? Ë, ce? Ce na hapni punë pa punë, apo s'u rri bytha rehat uve? Me uve po flas. Këtu ju mbajmë për punë dhe jo për istorira. Në galeri, marrsh, kush të dëgjojë emrin! Maskarenj, pisa."

"Pisat e sat ëme", - mërmëriti një zë pas meje.

U-u-u-u-u-u-u-u, u ngrit një ulërimë e kudoshme. U kreshpërua. Hera e parë që e ngrinim zërin së bashku. Qenkësh i fortë. Policët e lanë për një hop spektaklin e tyre barbar, sikur djalli t'ua kishte ndërprerë korrentin. Oficeri i rojës urdhëroi: vazhdoni, le të hungërijnë armiqtë! Oficeri i rojës u pataks i pari dhe tregoi me gisht nga salla që po dallgëzohej. Policët u vërsulën mbi rreshtat e parë, që të goditnin, por u goditën ata nga stola të tjerë e fshesa e pjata. Kjo po ndodhte në krye.

Të burgosurit nga fundi hipën mbi tryeza për të parë ç'bëhej. Pluhur, britma dhe shqyerje dërrasash, pastaj krahësh. Të guximshëm të tjerë, më të krisurit, po çanin përpara, duke hipur mbi kurrize e kokë, drejt betejës. Një tryezë u ngrit lart dhe u hodh me rrapëllimë andej ku policët dhe oficeri i rojës nuk po iknin dot. Të tjera tryeza u ngritën havadan. Dera qe bllokuar nga të burgosur. Po fluturonin stola si zhgaba druri, rrapëllima, thyerje xhamash. "Rroftë Flamuri pa yll! - kishte thirrur Hysen Xhani në Spaç. - Poshtë qeveria e Tiranës!" "Ja vdekje, ja liri!" - u dëgjuan thirrje të tjera. "Nuk punojmë në galeri…". "Rroftë Bashkimi Europian!" - u ngrit mbi të tjerët zëri i Bedri Çokut. E padëgjuar kjo thirrje, si, po bashkohet Europa, po ne?

Ka organizim? Tmerr? P…arti ilegale…Përtej rrethimit, te ndërtesa fshatare e komandës së burgut, shiheshin lëvizje të shqetësuara e dyfishim rojash. Edhe këtej nga ne, brenda telave me gjemba, rrëmuja po qetësohej, ndërkohë dëgjoheshin zëra të alarmuar: Ç'do të bëjmë? T'i mbajmë peng policët? Lirojini robërit, o robër, se kush thirri.

Natën shkruanim mureve të burgut parulla kundër: Poshtë komunizmi dhe Enver Hoxha! Rroftë liria, Europa, Amerika! Një kryengritës i ri tundte nga krahët shokët - ngadalë se më shqeve edhe më - të ngremë një barrikadë, thoshte, mbi udhën nga do të vijnë policët dhe oficerët e komandës. Të burgosurit zbythën një dyndje policësh, donin të hynin në kamp, të paarmatosur ishin; por u plogështuan menjëherë, ndërsa binin mbi ta gurë, pjata, sharje, libra të trashë të Enverit. Policët morën urdhër të prapseshin.

## TRE BREZA TË FAMILJES QERIMAJ NË KONCERT

Është quajtur "Harku i triumfit të Qerimajve" dhe është një koncert që mbahet në Amfiteatrin e Liqenit të Tiranës këtë 22 maj. Ngjarja kulturore bashkon në skenë jo vetëm 9 artistë e familjes Qerimaj, por edhe instrumentistë francezë, të cilët kanë realizuar kolonën zanore të filmit "Gladiator".

Koncerti do të jetë festiv dhe bën bashkë tre breza të familjes Qerimaj, me rastin e 85 - vjetorit të lindjes së babait të dinastisë muzikore, Ethem Qerimaj. Kompozitori, i cili njëkohësisht është edhe djali i tij, Fatos Qerimaj tha dje se do të prezantojnë instrumentistët para publikut shqiptar. 85-vjetorit të babait i kushtuam vëmendje, që ta bëjmë të lumtur këtë mbrëmje triumfale të karrierës. Prandaj edhe titulli 'Harku i Triumfit' është një abstragim i karrierës së tij artistike", tha Fatos Qerimaj.

"Kemi një suitë Tiranase, një nga Veriu edhe një nga Jugu. Koncerti do të përfshijë të gjitha trevat shqiptare", shtoi kompozitori Qerimaj, ndërsa vuri në dukje se të ftuar specialë në këtë koncert do të jenë instrumentistët francezë, të cilët kanë qenë pjesë e realizimit të kolonës zanore të filmit "Gladiator".

"Jam shumë i kënaqur që do të jem në këtë koncert në Tiranë. Do të luaj me du du, një instrument që ka qenë pjesë e shumë kolonave zanore. Ka qenë shumë e rëndësishme, që edhe në filmin gladiator është evidentuar më shumë ky instrument. Unë jam i lumtur që kam qenë pjesë e këtij udhëtimi", vërejti instrumentisti francez Levon Minassiay.

Familja Qerimaj në skenën e Amfiteatrit nesër ora 20.00 do të interpretojnë repertorin më të mirë të tyre nga tradicionalja, tek muzika ballkanike edhe ajo evropiane. Nuk do të mungojnë edhe shumë surpriza të tjera, të cilat do të shpalosen gjatë koncertit.

# REVOLTA E QAFË-BARIT
## DOSSIER

Ekskluzive / Zbulohet dokumenti i rrallë me siglën "sekret" i vitit 1984 i miratuar nga ministri i Brendshëm, Hekuran Isai

# Masat pas Revoltës së Qafë Barit: Bomba me gazlotsjellës dhe zvogëlimi i qelive në Burrel

*Kuadrot e lartë të Ministrisë së Brendshme që do i kryenin: Nga Agron Tafa, Zylyftar Ramizi, Dhimitër Krisafi, Ferit Zeneli, etj.*

Nga Dashnor Kaloçi

Plot 35 vjet më parë në 22 majin e vitit 1984, në kampin-burg të Qafë Barit në rrethin e Pukës ky vuanin dënimet një numër i madh të dënuarish politikë të regjimit komunist të Enver Hoxhës, ndodhi një ngjarje e jashtëzakonshme që tashmë është e njohur si "Revolta e Qafë Barit", ku diktatura komuniste në shenjë hakmarrje, më pas ekzekutoi me pushkatim dy të dënuar, Sokol Sokoli dhe Tom Ndoja. Si dhe ridënoi me burgime të rënda një numër të madh të dënuarish të tjerë, të cilët u etiketuan dhe u akuzuan si përgjegjësit kryesorë të asaj ngjarje. Po kështu nga torturat çnjerëzore dhe keqtrajtimi brutal që iu bë një numri të madh të dënuarish (që u konstatuan apo u akuzuan si përgjegjësit dhe organizatorët kryesorë të asaj revolte), nga ana e forcave ushtarako-policore dhe efektivat e tjera të repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (rep.326) që erdhën në përforcim nga Tirana, mbeti i vdekur edhe i dënuari politik, Sandër Sokoli, ish-kuadër i lartë ushtarak, që ishte diplomuar në Bashkimin Sovjetik. Ndërsa tashmë prej kohësh këto dhe të tjera detaje nga ajo ngjarje janë të njohura si prej dokumenteve arkivore të bëra publike pas viteve '90-të, ashtu dhe prej dëshmive të ish-protagonistëve të asaj revolte, ekskluzivisht për 'Gazeta Shqiptare'", po publikojmë për herë të parë një dokument krejt të panjohur, me siglen "sekret", i cili hedh dritë mbi masat që do ndërmerrte regjimi komunist me anë të autoriteteve përkatëse në mënyrë që "të mos ndodhnin më ngjarje të asaj natyre", ku ato masa përshkruhen me detaje, si dhe njerëzit e ngarkuar për zbatimin dhe kontrollin e tyre. Ajo që bie në sy në këtë dokument të rrallë që është nxjerrë nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme prej dosjes tepër voluminoze të asaj ngjarje që duhet thënë se tronditi jashtë mase udhëheqjen komuniste të Tiranës, është kërkesa për furnizimin me bomba me gazlotësjellës, helmeta, kundragaze dhe ushqim të lartë për ushtarët dhe efektivët, si dhe zvogëlimi i qelive në burgun e Burrelit e pajisja me uniforma njëngjyrëshe (të verdhë) e të dënuarve politikë që vuanin dënimet në të gjitha kampet e burgjet e atij regjimi. Për më shumë rreth kësaj, na njeh dokumenti të cilin po e publikojmë të plotë bashkë me faksimilet përkatëse.



6.

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|
| | problemе | | | | |
| 14. | Drejtoria e Zbatim Vendim Penale me Degen e Shërlidhjes të Shqipjes dhe marrin masa për riparimin e linjes Qaf Bari-Fush Arrës dhe shërlidhjen me rradio të tipit"Storno" repartin 305 Sarandë të cilat kanë një numër të madh të dënuarish që punojnë në siperfaqe të pyllëzuar. | Brenda vitit 1984 | Dh.Krisafi Q.Jagellari | A.Tafa | |

ZEVENDESMINISTRI I PUNEVE T. BRENDSHME
AGRON TAFA

MIRATOHET

Sekret

MINISTRI I PUNEVE TE BRENDESHME

Ekzemplar. Nr 1

HEKURAN ISAI

Tiranë.......1984

PLAN - MASASH

**PER ZBATIMIN E DETYRAVE QE DOLEN NGA KONTRILLI NE REPARTET E RIEDUKIMIT DHE DETYRAT E DALA NGA ANALIZA QE I BERI KOLEGJUMI NGJARJES SE QAFE BARIT TE DATES 22.v.1984**

Me qëllim që në repartet e riedukimit dhe burgjet të parandalohen ngjarjet e jashtëzakonshme, të forcohet vigjilenca në regjimin e të dënuarave dhe masat parandaluese operative-ushtarake për sigurimin e plotë të dënuarave në ruajtje, si në regjimin e fronteve të punës, veç detyrave që u janë lënë komandave të reparteve nga Drejtoria e Zbatim Vendimeve Penale, në zbatim me drejtorinë e I-rë të Sigurimit të Shtetit dhe drejtorinë Ekonomike, të merren edhe këto masa dhe detyra konkrete.

**1.** Të bëhet mbledhje me gjithë kryetarët e degëve të punëve të brendshme, komandat e reparteve dhe punëtorët operativë të reparteve të riedukimit dhe të punohen konkluzionet e ngjarjes së datës 22.V.1984 të Qafë Barit, duke vënë theksin në mangësitë dhe dobësitë në regjimin e brendshëm.

Koha e kryerjes deri në 20.5.1984. Ngarkohet: Dh. Krisafi. F. Haxhiu. Kontrollon: A. Tafa.

**2.** Të bëhet një përshkrim për mangësitë që janë vërtetuar në regullin e brendshëm në repartet e riedukimit, duke vënë shëmbulla konkrete, shkaqet e këtyre mangësive dhe masat që duhen marrë.

Koha e kryerjes, deri më 18.6.1984. Ngarkohet Dh. Krisafi A. Tafa

**3.** Për të stabilizuar regjimin e brendshëm të dënuarëve në disa reparte riedukimi ku vazhdimisht kemi pasur shqetësime, si në Sarandë, Batër, Lezhë dhe Spaç, të bëhen kontrolle të befasishëme nga Drejtoria e Kontrollit të Zbatimit Vendimeve Penale me forca të batalionit 326 të policisë, deri 1 togë.

Koha e kryerjes, Qershor - Korrik 1984. Ngarkohet Dh. Krisafi A. Tafa



MIRATON
...ISTRI I PUNEVE TE B...
HEKURAN ISAI

Me qëllim që n...
...rcohet vigjilenca ...
...nuarve në ruajtje ...
...eve, nga drejtoria ...
...it, dhe drejtorinë ...

Detyrat që do ...

...bëhet mbledhje me ...
...brendshme, komandat ...
...reparteve të rieduk...
...jarjes të dates 22.5...
... në dobësitë dhe me...

**4.** Për të meta dhe dobësi të theksuara që janë gjetur në repartet e sigurimit të të dënuarave dhe metodën e punës së komandave të reparteve, të thirren në raport tek zëvëndësministri, komanda e repartit 305 Sarandë dhe 301 Batër dhe të paralajmërohen dhe t'u vihen detyra për përmirësimin e gjëndjes.

Koha e kryerjes, Qershor 1984. Ngarkohet Dh. Krisafi A. Tafa

**5.** Drejtoria e I-rë e Sigurimit të Shtetit të bëjë një studim të thellë të veprimtarisë armiqësore në repartet e riedukimit dhe në burgjet dhe të përcaktohen masa konkrete për sektorin operativ ashtu dhe ushtarak në bashkëpunim me Drejtorinë e Zbatim Vendimeve Penale, për të parandaluar çdo të papritur e veçanërisht të goditen e shpartallohen format e organizuara të kësaj veprimtarie.

Koha e kryerjes, Qershor-Korrik 1984. Ngarkohet F. Haxhiu Dh. Krisafi. E kontrollon Z. Ramizi A. Tafa

**6.** Drejtoria e I-rë e Sig-



2

Drejtoria e Zbatim Vendim Penale në bashkëpunim ...
Ekonomike të marrin masa për sigurimin e të dënuarv...
e kushteve siç janë:
- Të sigurojë tel me xhëmba për rrethimin e pav...
...lit të burgjut, të burgut Burrelit dhe rrjeta teli ...
sanotoriumit.
- Të bëhet preventivi dhe të bëhen disa adaptime ...
Burrelit për zvogëlimin e dhomave dhe rritjen e ka...
- Të kompletohen repartet e riedukimit dhe burgj...
helmeta, bomba gazlotësjellëse, bilbila dhe lektrik ...
...ve për të rritur gatishmerinë.
- Të studjojnë mundësinë që norma e ushqimit të ...
...teve 321 Burrel, 302 Lezhë, 305 Sarandë, 313 e 325 ...
...itë e sherbimit tu jepet norma Dy.
- Të merren masa që të bëhet më mirë furnizimi ...
riedukimit me veshje për të dënuarit të nji ngjyre ...
...batanie, çarçafë e sende të tjera të nevojshme.
"Në repartin 303 Spaç të zgjidhen problemi i de...
e furres bukës së efektivit brenda vitit 1985 duke ...
...ndërmarrjen e minieres si dhe problemi i furnizimit ...
...së II-të

Opinioni i Ditës

# Për poetët, librat dhe fashizmin

Nga Halil Matoshi

*(vijon nga faqja 1)*



1.
...j të secilit fashist, kudo dhe kurdo.

E dija se nuk ka armë që i bân ma shumë nervoz dhe i tmerron fashistët se sa libri!

Dhe kam bâ mrekulli t'i strehoj ato, duke bâ një bunker ku i kam groposë rreth 2000 tituj, që nga Iliada e Homerit e deri tek antifashisti Danilo Kiš!?

Masanej gjithçka nisë me pamjen kur të detyrojnë me ra në gjunjë, me duer të lidhuna mas kreje…

Dhe ti pret nji plumb në kokë dhe krejt jeta të shfaqet me shpejtësi si në retrovizor.

Të tjerat janë kujtesë.

2.
Fashizmi âsht brutal, por i varfër dhe qesharak po mos t'ishte tragjik për historinë e re të njerëzimit.

Vepron simas skemës: Në luftën tonë nuk ka të pafajshëm dhe secili që nuk âsht me ne âsht anmiku ynë, pavarësisht përkatësisë apo të bâmave.

3.
Dy miqtë e mi, poetë fort të çmueshëm, Xhevdet Bajraj dhe Arben Idizi e kanë poetizu mizorinë e trishtë të fashizmit, me gjithë anën e tij karikaturiale, që spikatë moralin e ultë dhe injorancën e trurit-muskul (Gustav le Bon) të fashistit tipik.

Poeti Bajraj e shfaq këtë makth të madh në poezinë "Djali ishte gjashtë vjeç, vajza tetë dhe qanin" që âsht gjyqi ma kuptimplotë për fashizmin.

Ndërsa Idrizi shëmtinë e fashizmit e nxjerr në pah në mënyrë tallëse në poezinë "Midis të pushkatuarve ishte edhe një i sëmurë mendor".

4.
Paragjykimi kognitiv për superioritetin e fashistit tipik, që buron nga padija e skajshne, cilësohet nga psikologët si "Efekti Dunning-Kruger", që shpërfaqë injorantin, i cili nuk gjykon me arsye sepse ikonografia dhe fjalët ikonike (parullat) për një kohë relativisht të gjatë ia shplajnë trunin duke ia "injektu" sindromën se atij/akëcilit sapo i âsht dhânë ni mision historik, në emën të kombit dhe atdheut, rol për të cilin ai s'di asgjâ, prandaj fashisti âsht kampion i mosdijes!?

5.
Kur fashistët e zunë Federico Garcia Lorka-n, ai tashmâ ishte i lumtun: Kish mbrri me i groposë nën rrâjtë e nji çiparisi poezitë e tij, tuj e vù ni shéj për të afërmit e tij.

Sa herë në makthin e burgut të Lipjanit dhe Kampin e Përqëndrimit "Zabela" të Po•arevac-it (Serbi) kam mendu se kanë me na pushkatu, m'kanë dalë para syve librat, titujt madje dhe ngjyrat e kopertinave, sikur sheh një protestë antifashiste, si ato të 1981, 1989-90 dhe 1997-98, në të cilën germat janë armë!?

Poetët janë senzorët që parandjejnë ardhjen e fashizmit!

6.
Në vitet '90 gjithçka nisi në fjalë!

Në Radiotelevizionin e Serbisë nisi POGROM-i antishqiptar (nga fjala ruse 'gromit' e fillimshekullit të 20-të, që dmth. 'shkatërrim me përdorim të dhunës', si referencë për "Natën e xhamave të thyem") që u bart në mitingjet kinse të solidaritetit, me thirrje e kângë dhe pastaj fjalët filluen me u shkëmby në plumba, për me i vra ata që mendonin ndryshe.

Pra, lufta e Kosovës âsht fillue në RTS.

7.
Njizet vjet mas luftës në Kosovë, lidershipi politik i Serbisë, në vazhdimësi po i inkurajon huliganët dhe nacionalistët ekstremistë kundër qytetarëve shqiptarë, që jetojnë e punojnë në këtë shtet.

Versulja drejt dyqaneve me pronarë shqiptarë, siç ndodhi para do kohe në Borça të Beogradit, me thirrje për gjenocid në Kosovë si dhe protestat e disa serbëve, janë 'de ja vù' që përgatitën momentumin psikosocial për "Natën e kristaltë" kur nga nazistët u sulmuan masovikisht hebrenjtë dhe bizneset e tyne, në disa qytete gjermane.

Propaganda e tillë shenjestruese ndaj grupeve tjera etnike apo kulturore âsht frikë joracionale, fobi ndaj tjetrit dhe si këshilltari më i keq i mundshëm, rëndom shpie në dhunë.

Metodat e linçit ndaj fqinjve të parë, që janë të njohura për Europën e mesit të shekullit XX, pamje të rishme në Beograd, janë prolog për sulme masive ndaj shqiptarëve dhe si të tilla, autoritetet serbe nuk kanë sens për me i parandalue, sepse në vet qenien serbe nuk ka ndodhë defashistizimi, prandej shoqnia serbe nuk ka fuqi ta frenojnë rikthimin e fashizmit.

Pra, fashizmi nisë rëndom në fqinjësi!?

Nëse nuk reagohet, ai përbrendësohet dhe rritet si tumor malinj, brenda njeriut.

8.
Krimi i padënuem rëndom ngjiz nji krim të ri, sepse shpirti i fashistizuem nuk resht me u rikthy tek narrativa e gjakut, në pafuqinë për ballafaqim me veten, për me e përjetu katarsis-in.

Kosova duhet me e shkru "Librin e Zi" qe me forcën e argumenteve e jo me qasje emotive dhe politizuese, tuj ra pré e errësimit të mendjes që shpie në dhunim të fakteve e jo në ndriçimin e tyne sy bote, me e dokumentue kështu intencën gjenocidiale të Serbisë.

Shteti serb duhet te paditet për gjenocid në Gjykatën Ndërkombëtare Penale!

Kjo mbase mund ta trand shoqninë serbe dhe ta nxisë me i pranu krimet, me i dënu ato si e vetmja mundësi për me hjekë dorë nga fashizmi!?

Refuse the fascism now!



Opinioni i Ditës

# Sekret diplomatik, por edhe informim publik!

Nga Jorgji Kote

*(vijon nga faqja 1)*

... treguar as drejtuesve të Komisionit të Jashtëm mbi vizitën sekrete në Phenian, në fillim të atij muaji. Megjithatë, shumica e senatit me votën pro i bindi ata se në një rast të tillë, kur sapo ishte konfirmuar Samiti i parë Trump-Kim Jong Un, sekreti ose konfidencialiteti është vendimtar për suksesin politiko-diplomatik. Dhe ky nuk është rasti i vetëm në politikën dhe diplomacinë amerikane. Kështu, pa vizitat dhe takimet sekrete të ish-sekretarit emblematik të Shtetit, Henry Kisinger në Pekin në vitin 1971 dhe takimi i tij me ish-kryeministrin kinez Çu en Lai, nuk do të ishte realizuar hapja historike amerikano-kineze. Po ashtu, marrëveshja historike me Iranin për armët bërthamore e vitit 2015 mund të mos ishte mundësuar pa ndërmjetësimin e fshehtë të dy të dërguarve specialë të Presidentit Obama, William J.Burns dhe Jake Sullivan në Teheran më 2013-ën.

Këto dhe plot shembuj të tjerë nga praktika e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ajo e vendit tonë tregojnë se me gjithë daljen më në pah të diplomacisë dhe transparencës publike në dy dekadat e fundit, sërish ka çështje që janë tejet delikate për të dalë në publik pa ardhur momenti i duhur. Këto dhe të tjera raste dëshmojnë se pa mbajtur "me fanatizëm sekretin", apo siç quhet me eufemizëm mirëbesimin e nevojshëm ndërmjet palëve nuk mund të ketë "breakthrough", pra arritje të shënuara në politikën e jashtme.

Ashtu siç përmendet edhe në librin "Diplomacia për të gjithë" (2014) një ndër çelësat e efektivitetit diplomatik, pavarësisht nga karakteri i saj publik në rritje është që për vendime të veçanta të mbahet deri në fund mirëbesimi i nevojshëm mes palëve. Kjo do të bëjë të mundur që çdo hap dhe veprim i diplomacisë të bëhet në qetësi, në respekt të kërkesave të lartpërmendura, me qëllim që ato të mos çojnë në mediatizimin e teprur, për pasojë kompromentimin e procesit e ca më keq akoma, në lëndimin apo dëmtimin e palëve në këto procese ose humbje të besueshmërisë së tij te partnerët e tjerë.

Kjo nuk nënkupton aspak që të mbahen gjërat fshehur ndaj publikut; përkundrazi, sot diplomacia zyrtare po shquhet dhe për natyrën e saj gjithnjë e më shumë publike. Por, fjala është për konfidencialitetin si metodë pune, e cila i krijon kushte, mundësi, kohë dhe hapësirë veprimi kanaleve diplomatike dhe vendeve partnere për zgjidhjen sa më optimale e të pranueshme dhe me interes publik për të gjitha palët.



Sepse pavarësisht nga karakteri i saj specifik, diplomacia është gjithsesi pjesë përbërëse e pushtetit ekzekutiv; ajo përgjigjet për veprimet e saj përpara qeverisë, parlamentit, kreut të shtetit dhe opinionit publik. Proceset dhe vendimet e saj kanë jehonë, merren shënim dhe krijojnë reagimet e rastit me ndikimet përkatëse edhe në kancelaritë e vendeve dhe organizmave shumëpalësh.

Përvoja ndërkombëtare dhe ajo e vendit tonë gjatë viteve të fundit jep shumë shembuj për pasojat negative të "fshehjes" prapa sekretit diplomatik, në radhë të parë për interesat strategjike të vendit. Rasti më tipik i kësaj mungese është procesi i negociatave deri te nënshkrimi i Marrëveshjes së Detit më 2009 me Greqinë, e cila u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2010.

Në respekt edhe të drejtuesve dhe kolegëve të shumtë të diplomacisë sonë, me të cilët punova për disa dekada deri në vitin 2017, më poshtë po shpreh disa shqetësime dhe sugjerime konkrete dashamirëse dhe profesioniste.

Pas disa hapave pozitive në këtë fushë, tani së fundi po vërehen sërish mangësi shqetësuese lidhur me informimin publik, duke filluar pikërisht nga negociatat e rifillуara në nëntor 2017 dhe të ndërprera gati një vit më parë. Po kalon gati një vit nga dorëheqja e Kotzias dhe gjashtë muaj nga largimi i Bushatit, por nuk kemi dëgjuar më asgjë për fatin e këtyre negociatave. A janë ndërprerë apo anuluar tërësisht për të rifilluar në një format tjetër më të mundshëm? Sepse edhe strategjia e mëparshme për t'i zgjidhur të gjitha çështjet e nxehta me Greqinë me metodën e "aksionit" dmth., me një marrëveshje të vetme dhe brenda disa muajve ishte tërësisht jashtë realitetit, ndaj jo vetëm nuk u zgjidh ndonjë gjë e madhe nga axhenda e "nxehtë", sikurse u trumbetua me të madhe, por tani pala greke po shton dozat e trysnisë lidhur me pretendimet e saj për respektimin e të drejtave të pakicave etnike.

Më tej, "terri" informativ publik është edhe më i madh lidhur me qëndrimin e qeverisë dhe diplomacisë sonë për tezën famëkeqe të ndryshimit/korrigjimit të kufirit Serbi-Kosovë. Me përjashtim të ndonjë deklarate apo pohimi fare të vakët, të paqartë dhe kontradiktor, publiku ynë nuk e ka ende të qartë qëndrimin zyrtar. Ose më mirë të themi, ka më shumë tymnajë dhe perceptime, ndaj MPJ-ja duhet urgjentisht të sqarojë shqipshe pozicionin tonë lidhur me këtë çështje djegëse, që mund të bëhet pengesë edhe për integrimin tonë të mëtejshëm evropian. Për më tepër se në këtë rast nuk ka fare sekret diplomatik, sepse shtete të mëdha si Gjermania dhe të tjera e kanë bërë të qartë si drita e diellit pozicionin e tyre kundërshtues. Nëse ndonjë lideri këtu e në Kosovë nuk i hyjnë në vesh apo nuk duan ta kuptojnë gjuhën, etikën dhe "Jo"-në diplomatike, kjo është punë e tyre, por publiku i gjerë dhe shoqëria nuk të fal.

Mungesa e tretë e informimit publik ka të bëjë me reformën në shërbimin diplomatik të njoftuar tre muaj më parë. Deri tani nuk ka asnjë informacion, me përjashtim të lirimit dhe shkarkimit të 28 diplomatëve, të cilët madje gabimisht "u futën në një thes" me etiketime jo bindëse "pellgjesh, nepotizmi, krushqish" si dhe targave/pasaportave diplomatike të skaduara. Këto të fundit janë në fakt të dorës së tretë në hierarkinë e sfidave madhore të diplomacisë sonë, me brenda dhe me jashtë. Për më tepër, kjo periudhë koincidoi edhe me caktimin e një ministri të ri të Jashtëm në detyrë, që ndonëse pa ndryshime në vijat e përgjithshme të politikës sonë të jashtme, sërish duhet të bënte të ditur profilin dhe specifikat e tij. Ndryshe, ç'kuptim kishte ndryshimi i lartpërmendur, që sërish mbetet një enigmë tjetër për publikun, duke i lenë vend thashethemeve dhe spekulimeve të ndryshme, gjithsesi të justifikueshme në mungesë të informimit të drejtë e në kohë të publikut. Shkurt, ky i fundit duhet të njoftohet në vazhdimësi sa e si duhet mbi këtë reformë bashkë me komponentët e saj themelorë; ajo lipset të jetë tërësore, e argumentuar qartë dhe në bashkëpunim me aktorë/faktorë të tjerë përkatës jashtë MPJ-së; vetëm kështu reforma e pretenduar do të jetë e besueshme e për rrjedhojë efektive. Por, deri tani kemi dëgjuar vetëm për shkarkime, lëvizje dhe zëvendësime, qoftë edhe me "ekselentë" e në kundërshtim me ligjin përkatës të miratuar më 2015-ën nga kjo shumicë parlamentare.

## HOROSKOPI

### DASHI
Disa persona të caktuar duan të mirën tuaj, por këshilla e tyre mund të mos jetë e përshtatshme për situatën aktuale. Megjithatë, merrni në konsideratë çfarë thonë ata dhe përshtateni sa më mirë. Mos u dorëzoni dhe ndiqni ëndrrat.

### DEMI
Shkolla e jetës do t'ju japë mësime të rëndësishme sot. Një prej tyre ka gjasa të ketë lidhje me financat tuaja. Përpiquni t'i përmbaheni buxhetit dhe të mos kryeni shpenzime të papritura, pasi rrezikoni të mbesni pa para.

### BINJAKET
Merreni me qetësi punën sot dhe mos u nxitoni kur keni të bëni me çështje delikate. Kjo këshillë vlen edhe për jetën personale. Dikush të cilin ju e doni shumë, do të ketë nevojë të diskutojë disa çështje të rëndësishme.

### GAFORJA
Do të ndiheni disi të irrituar gjatë ditës së sotme. Disa pajisje nuk do të punojnë siç duhet. Bëni shumë kujdes teksa jeni në trafik. Tregoni durim gjatë ditës dhe përpiquni të mendoni pozitivisht.

### LUANI
Kjo e mërkurë do të jetë një ditë mjaft interesante. Do të jeni të ngarkuar në punë, por jo gjithçka mund ta përfundoni sot. Në mbrëmje do të merrni një dhuratë, e cila do t'ju kënaqë pamasë. Gjithashtu, do të suprizoheni nga arritjet e një të afërmit tuaj në moshë të re.

### VIRGJERESHA
Bëni kujdes me fjalët dhe veprimet tuaja. Ka gjasa që teksa përpiqeni të jepni një këshillë të vlefshme, do të përfundoni duke thënë diçka fyese. Bëni kujdes lidhur me këtë në punë. Nëse veproni kështu, gjithçka do të ecë qetësisht.

### PESHORJA
Sot do të ndiheni mjaft i motivuar. Kjo do t'ju sjellë lumturi dhe do të ndikoni pozitivisht te të tjerët. Megjithatë, ekziston mundësia që gjërat të ndryshojnë pas një takimi serioz që do të zhvilloni gjatë kësaj të mërkure.

### AKREPI
Nëse ju duhet të ndërmerrni një vendim për punën, bëni mirë të vendosni sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të mos humbisni një mundësi mjaft të mirë. Kur të komunikoni me të tjerët, tregohuni të vëmendshëm ndaj çdo fjale.

### SHIGJETARI
Nuk do të jetë e mundur të keni rol drejtues në një projekt sot, edhe pse mund të jeni të përshtatshëm për atë. Megjithatë, përpiquni ta pranoni këtë dhe ecni përpara. Ka gjasa të konfliktoheni me një anëtar të familjes, i cili mund të fyhet nga fjalët tuaja.

### BRICJAPI
Ka gjasa që sot të ndiheni të stresuar. Përpiquni maksimalisht për të qenë i qetë, i duruar dhe produktiv në punë. Mund të keni ide mjaft të mira sot, mund të kuptoni të vërtetën te një mik, ose t'i jepni fund një konflikti të vjetër.

### UJORI
Nëse ndiheni shumë të ngarkuar emocionalisht, rekomandohet të kërkoni ndihmë sa më shpejt të jetë e mundur. Ka gjasa që nëse prisni më shumë, mund t'ju "kushtojë më shtrenjtë". Kur të flisni me të tjerë, tregohuni vetvetja dhe flisni hapur.

### PESHQIT
Gjendja juaj emocionale do të ndryshojë gjatë ditës së sotme. Përpiquni të mos shqetësoheni dhe të mos ndikoni te të tjerët lidhur me këtë. Në mbrëmje rekomandohet të ndryshoni rutinën dhe të vizitoni disa miq të vjetër, ose të planifikoni pushimet.

KOMBËTARJA

## Lista paraprake, Reja zyrtarizon të grumbulluarit



Ashtu siç edhe është bërë e ditur, Edi Reja ka nisur grumbullimin në Durrës dhe ka ftuar disa futbollistë, të cilët për momentin janë pushim për shkak se kanë mbyllur sezonin me skuadrat e tyre respektive. Në kompleksin "Tropikal" janë grumbulluar 10 futbollistë nga ekipi i parë i Shqipërisë, ndërkohë që ka edhe 12 futbollistë, të cilët do të jenë pjesë e Shpresave. Kështu, sot skuadra ka zhvilluar stërvitjen e parë nën drejtimin e Rejas dhe 10 futbollistët do të jenë nën vëzhgim para se të publikohet lista përfundimtare ditën e hënë. Deri të shtunën, Shqipëria do të kryejë stërvitje në kompleksin "Tropikal", aty ku edhe grumbullohet Shqipëria prej kohësh. Në sy bie fakti që ka 3 futbollistë nga Partizani, ndërkohë që ka edhe nga të rinj, të cilët grumbullohen me Shpresat për herë të parë. Të shtunën, futbollistët e Shpresave do të largohen nga grumbullimi dhe do të nisin një tjetër grumbullim më pas, aty ku do të jenë nën urdhrat e trajnerit Alban Bushi, i cili do të publikojë listën e tij për ndeshjen zyrtare ndaj Turqisë në transfertë dhe dy miqësoret ndaj Uellsit në Shqipëri.

Lista e 22 lojtarëve

Alban Hoxha, Enea Mihaj, Kastriot Demarku, Migjen Basha, Ergys Kaçe, Emanuele Ndoj, Eros Grezda, Lorenc Trashi, Ylber Ramadani, Bruno Telushi, Andrea Hoxha, Din Sula, Kleando Lleshi, Leonardo Maloku, Omar Imeri, Shefit Shefiti, Arbin Zejnullai, Esat Mala, Sergio Kalaj, Drilon Kryeziu, Agim Zeka, Blerton Sheji.

Ergys Kaçe dhe Andi Lila janë duke biseduar, ndërsa ish-lojtari i Skënderbeut e mohon

# Në Tetovë e çojnë te Shkëndija, Lilaj: Nuk di asgjë, s'kam folur me kënd

## Kuqezinjtë e Tetovës duan ekipin e ëndrrave në Europë



Jeton Selimi



Shkëndija festoi këtë sezon titullin e tretë në histori, ndërsa ishte i dyti radhazi. Tetovarët tashmë janë të përqendruar te përforcimet, teksa ekipi do të marrë pjesë në kompeticionet europiane. Mbi këtë temë foli edhe presidenti i Shkëndijës, Visar Bexheti, i cili njoftoi se ishte në kontakte për të afruar lojtarë të Kombëtares që organikën e skuadrës. Ditën e djeshme janë zbuluar emrat me të cilët presidenti do të tentojë t'i afrojë në skuadër. Sipas portalit "InfoSport.mk", bëhet fjalë për Ergys Kaçe dhe Andi Lilën, ndërsa interesim ka pasur edhe për Sabien Lilajn. Lilajt i skadon kontrata në qershor dhe më pas do të jetë një futbollist i lirë. Sa i përket mesfushorit Kaçe, futbollisti mbylli huazimin te Panathinaikos dhe tashmë do të kthehet Paoku, edhe pse Kaçe nuk është në planet e grekëve. Paoku do të kërkojë ta huazojë sërish dhe këtë formulë do të kërkojë ta shfrytëzojë edhe Shkëndija. Ndërsa, edhe Andi Lila duket se e ka mbyllur aventurën në Greqi, teksa ekipi i tij Pas Janina ka rënë një Kategori më poshtë dhe mbrojtësi i krahut është i hapur për një aventurë të re teksa me Shkëndijën do të kishte mundësinë për të luajtur në Kupat e Europës.

**LILAJ: NUK DI ASGJË**

Lajmi i orëve të fundit dje ishte se ish-futbollisti i Skënderbeut, Sabien Lilaj, do të kalojë te Shkëndija e Tetovës për të luajtur në Champions League. Ishte "Procesi Sportiv", që e publikoi këtë lajm dhe më pas u përhap me shpejtësi edhe në medie të tjera. "Vipsport.al" kontaktoi me Sabien Lilajn, i cili ka dhënë një përgjigje të shkurtër për këtë çështje: "Nuk di asgjë se çfarë është shkruar. Ajo që ju them me siguri, është se nuk kam folur me asnjë njeri". Ky është qëndrimi i mesfushorit korçar. Ai vetë nuk ka pasur kontakte me askënd dhe mbetet të shihet se çfarë do të ndodhë në vazhdim. Ndoshta drejtuesit e Shkëndijës e duan në ekip, por nuk është kaq e thjeshtë. Lilaj mbylli sezonin e parë në Azerbajxhan, me ekipin e Gabalas, ku ka bërë paraqitje të mira dhe ditët e fundit fitoi trofeun e parë në këtë vend, kupën. Koha do të tregojë, nëse Lilaj do të ndërrojë ekip dhe nëse po, ku do të shkojë. Emri i tij është përmendur më parë edhe në kampionatin shqiptar te Tirana, por rikthimi në vend do të ishte opsioni i fundit për 30-vjeçarin.

SULMUESI UELLSIAN

## Gareth Bejl: Futbollistët janë thjesht 'robotë'

Gareth Bejl nuk përdor gjuhë të mesme në një intervistë dhënë për "BT Sports Film". Situata e tij te Reali i Madridit është kthyer në një tension të vërtetë, me trajnerin Zinedin Zidan, që nuk e preferon më uellsianin në ekip, duke i treguar derën. Nga ana e tij, Bejl ka treguar se ka ndërmend të respektojë kontratën. "Lojtarët janë 'robotë'. Një profesionist futbolli nuk mund të caktojë kalendarin e tij apo ndeshjet, siç ndodh në sporte të tjera sikundër tenisi apo golfi. Na thonë se ku duhet të shkojmë dhe kur duhet të shkojmë, çfarë duhet të hamë dhe sesi duhet ta kalojmë kohën me trajnerin. Është njëjtë sikur të humbasësh jetën tënde në këtë botë".

EUROPA LEAGUE

## Lufta Azerbajxhan-Armeni, Mkhitarjan humbet finalen ndaj Çelsit



Duket e pabesueshme që situata të tilla të ndodhin në vitin 2019, por ja që ekzistojnë dhe të bëjnë të mendohesh gjatë. Ylli armen i Arsenalit, Henrik Mkihtarjan, nuk do të jetë prezent në finalen e Europa League kundër Çelsit, kjo për shkak se ndeshja zhvillohet në kryeqytetin e Azerbajxhanit, Baku, shtet që ka konflikte politike me Armeninë për shkak të pretendimeve territoriale mes dy vendeve. Në një postim në profilin e tij në "Twitter", Mkihtarjan ka shprehur hidhërimin e tij për shkak se nuk do të jetë prezent në finalen e madhe kundër Çelsit, ndërsa është treguar i kujdesshëm që të evitojë provokimet. "Është ajo lloj ndeshjeje, që ne lojtarët nuk kemi mundësi ta luajmë shpesh dhe më duhet ta pranoj se më dhemb shumë fakti që nuk do të jem. Do të bëj tifo për shokët e skuadrës. Silleni kupën në shtëpi", shkruan Mkhitarjan.

TRAJNERI I "GJELAVE"

## Deshamp: Unë te Juventusi? Nuk lëviz nga Franca



Franca dhe vetëm Franca! Për Didie Deshamp nuk ka asnjë stol tjetër përveçse atij të Kombëtares transalpine, kampione e botës në fuqi. Madje, as ai i Juventusit. Ish-mesfushori bardhezi në konferencën e fundit për shtyp ku ka shpallur listën e lojtarëve për sfidat e ardhshme të Francës, ka kërkuar të sqarojë çdo gjë. "Situata është e thjeshtë. Të gjitha energjitë e mira dhe përqendrimi im janë vetëm te kualifikimi i Francës për në Europian dhe shpresoj që të jemi aty. Unë e kam të qartë situatën. Edhe pse më vjen mirë që flitet për mua dhe për ekipe të mëdha si Juventusi, ku shikohem si pasuesi i Alegrit. Sot e ardhmja ime është e lidhur me Kombëtaren franceze. Nuk do ia hap derën asnjë alternative tjetër".



**Skaloni e lë jashtë Kupës së Amerikës**

## Edhe Argjentina i bën dalje Mauro Ikardit!

Leo Mesi po, Dibala po, Martinez po, Ikardi jo! Lista e Kombëtares së Argjentinës e publikuar pak çaste më parë i ka dhënë një tjetër goditje sulmuesit të Interit, që po kalon një gjysmësezoni krejtësisht negativ. Mauro Ikardi nuk do të jetë pjesë e 23 lojtarëve që do të shkojnë në Brazil, me synimin për të fituar Kupën e Amerikës. Trajneri i "albicelestes", Lionel Skaloni, ka vendosur t'i besojë Lautaro Martinezit dhe Paolo Dibalës, që ishin në balotazh me Ikardin.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
MARKETING: 0688087323
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
VIP
BLUE TOOTH
Brikena Duva:
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al